



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

RAPORTI VJETOR 2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP

Prishtinë, Maj 2020

Rruga Luan Haradinaj "Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati –I-, 10000 Prishtinë

info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org 038/211-242

Përmbajtja

Përmbajtja	3
Lista e Shkurtesave	6
Vizioni dhe Misioni	7
Vizioni	7
Misioni	7
Përmbledhje Ekzekutive	7
Korniza Ligjore – Emërimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	13
Takimet/Mbledhjet e PZAP-IT	15
Struktura Organizative dhe Burimet Njerëzore të PZAP-IT	15
Sekretariati i PZAP-IT	16
Struktura Organizative e Sekretariatit	16
Organogrami i PZAP-IT	17
Objektivat e Sekretariatit të PZAP-it të realizuara gjatë vitit 2019	18
Publikimet e Sekretariatit të PZAP-it në Ueb faqen e tij	18
Punëtoritë, Trajnimet dhe Vizitat Zyrtare Jashtë Vendlindjes	20
Punëtoritë e PZAP-it	20
Punëtoritë e parë të mbajtura nga data 27-31 Mars 2019	20
Punëtoritë e dytë të mbajtura nga data 06-09 Qershor 2019- Hartimi i dokumentit të Historikut të PZAP-it	20
Punëtoritë e organizuara nga OSBE-ja nga data 04-06 Dhjetor 2019:	20
Trajnimet e PZAP-it	21
Vizitat zyrtare jashtë vendlindjes	22
Vizita në Finlandë nga data 13 Prill 2019 deri më 16 Prill 2019	22
Vizita në Bosnjë dhe Hercegovinë –Sarajevë nga data 30 shtator-1 tetor	22
Aktiviteti i Grupit Punues për hartimin e Buletinit të PZAP-it II	23
Grupi Punues për hartimin e Historikut të PZAP-it 2000 - 2017	23
Departamenti Ligjor	24
Aktivitetet lidhur me çështjet e personelit të Sekretariatit të PZAP-it	25
Aktivitetet lidhur me certifikimin e shpenzimeve financiare për nevojat të PZAP-it	27
Aktivitetet e Prokurimit për nevojat të PZAP-it	28
Bashkëpunimi i PZAP-it me aktorët e zgjedhjeve	28
Bashkëpunimi me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE	29

Bashkëpunimi i PZAP-it me Fondacionin Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore – IFES	29
Transparenca - Komunikimi dhe Informimi Publik.....	30
Transparenca me Misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë për Vëzhgimin e Zgjedhjeve - MBEVZ	30
Komunikimi me media dhe me publikun.....	30
Tryezat e organizuara nga Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D).....	31
Takimi me subjekte politike dhe me përfaqësuesit e OJQ-ve	32
Shpërndarja e Formularëve të Ankesave:	33
Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.....	34
Apelet e parashtruara në PZAP nga Subjektet Politike jashtë procesit zgjedhor, respektivisht kur nuk ka pasur zgjedhje.....	35
Njoftimi i PZAP-it nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës me kërkesat e parashtruara në këtë Gjykatë dhe Aktvendimet e Gjykatës lidhur me këto raste	36
Përmbledhje e informatave dhe të dhëna statistikore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend Të Republikës Së Kosovës Të Mbajtura Me 6 Tetor 2019	38
Ankesat e hetuara në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR – KQZ.....	40
Ankesat/Apelet e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës:	40
Natyrë e ankesave dhe apeleve të zgjedhjeve të 6 Tetorit 2019	43
Parashtruesit e ankesave/apelave në zgjedhjet e 6 Tetorit 2019	47
Kryerësit e supozuar në Zgjedhjet e 6 Tetorit 2019.....	49
Ankesat e parashtruara sipas komunave ku kanë ndodhur shkeljet gjatë Zgjedhjeve të 6 Tetorit 2019...	51
Rastet e dorëzuara në Zyrën e Prokurorit të Shtetit	53
Raporti i Buxhetit dhe Shpenzimeve Vjetore për Vitin Fiskal - 2019	55
Hyrje	55
Buxheti i Planifikuar Dhe Aprovuar për vitin – 2019.....	55
Buxheti fillestar i aprovuar dhe buxheti i ndryshuar gjatë vitit 2019.....	56
Struktura e buxhetit për vitin 2019	57
Buxheti i Shpenzuar për Vitin 2019.....	58
Paga dhe mëditjet.....	59
Mallra dhe Shërbime	61
Pjesa përmbyllëse e Raportit të Shpenzimeve	63
Të Hyrat e PZAP-it	64
Të Hyrat e Realizuara gjatë vitit 2019	67
Njësia e Teknologjisë Informative dhe Logjistikës	69

Njësia e Përkthimeve	70
Njësia e Transportit.....	71
Përfundime	72
Aktivitetet e PZAP-it në përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor në Kosovë.....	73
Sfidat.....	85

Lista e Shkurtesave

PZAP – Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
SPZAP – Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës
PK – Policia e Kosovës
MF - Ministria e Financave
MAP – Ministria e Administratës Publike
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
IFES – Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore
LZP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
LZL – Ligji për Zgjedhjet Lokale
ZRPPC - Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim
SP - Subjektet Politike
KP – Kandidat i Pavarur
QNR – Qendra për Numërimin e Rezultateve
SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SIMBNJ – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – MAP
SIMR – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Rasteve
NJQH - Njësia Qendrore Harmonizuese
ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
DASHC – Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil

Vizioni dhe Misioni

Vizioni

PZAP-i është dhe synon të jetë një institucioni i besueshëm, i qëndrueshëm, i fuqizuar dhe inovativ që bashkëpunon për forcimin e drejtësisë zgjedhore.

Misioni

PZAP-i me qëllim të fuqizimit të demokracisë është i përkushtuar që me profesionalizëm, paanshmëri dhe me kohë të zgjidhë kontestet zgjedhore për të siguruar të drejtat për të gjithë aktetë lidhur me procesin zgjedhor.

PZAP është i përkushtuar për përmbushjen me besnikëri të detyrave në përputhshmëri me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Të gjitha vendimet i merr në baza etike duke u bazuar në të gjitha provat për të promovuar besimin publik në aktivitetet e tij në përputhshmëri me ligjin, të pa ndikuara nga jashtë. Është i hapur dhe është përgjegjës për veprimtarinë që zhvillon, si dhe siguron qasje për marrjen e informatave për të gjitha palët e interesuara.

Përmbledhje Ekzekutive

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i) gjatë vitit 2019 shënoj suksese të reja dhe zhvilloj aktivitete të shumta, të cilat janë prezantuar në mënyrë më të hollësishme në këtë raport vjetor.

Raporti vjetor i punës pasqyron objektivat dhe aktivitetet e PZAP-it të kryera gjatë vitit 2019, në veçanti pasqyron punën dhe rezultatet e arritura të departamenteve dhe të njësive tjera të administratës së sekretariatit si dhe punën e panelit në shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave/apelve, të parashtruara nga subjektet politike, kandidatet e tyre, OJQ-të, si dhe palët tjera të interesit për shkeljet e përcaktuara me LZP dhe rregullat zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, të mbajtura më 19 Maj 2019 dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura më 6 Tetor 2019. Raporti përmban të dhëna statistikore përkitazi me numrin e ankesave/apelve të pranuar, të shqyrtuara dhe vendosura gjatë dy proceseve zgjedhore të mbajtura në vitin 2019, seancat e mbajtura, natyrën e ankesave, sanksionet e shqiptuara nga PZAP-i ndaj subjekteve politike, sanksionet e shqiptuara ndaj anëtarëve të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve, vendimet administrative për funksionimin e PZAP-it, dokumentet e përgatitura dhe të finalizuara nga PZAP-i si: Rregulloret e brendshme të PZAP-it, Buletini i PZAP-it – botimi i dytë, Historiku i PZAP-it për periudhën kohore 2000-2017, planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit, aktivitetet e prokurimit, aktivitetet e personelit. Raporti gjithashtu

përmban të dhëna për pjesëmarrjen e anëtarëve të PZAP-it dhe stafit të sekretariatit në konferencat dhe punëtoritë e organizuara, vizitat e realizuara në vend dhe jashtë vendit, trajnimet e organizuara nga PZAP, si dhe bashkëpunimet në mes të akterëve pjesëmarrës në procese zgjedhore.

Të dhënat e paraqitura në raportin vjetor, janë dëshmi e punës së kryer me përkushtim dhe profesionalizëm nga ana e kryesueses dhe anëtarëve të PZAP-it, stafit të administratës të sekretariatit që njëherësh do të jenë motiv shtesë për angazhimin e tyre të mëtutjeshëm në tejkalimin e sfidave në proceset e ardhshme zgjedhore dhe në vitet kur nuk ka zgjedhje.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa punën e tij e ka përqendruar në drejtim të përmbushjes së objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara me Planin Vjetor të Punës për vitin 2019, si dhe me Planin Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019. Poashtu, ka kryer punë dhe aktivitete të tjera të cilat nuk kanë qenë të planifikuara me Planin Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2019, siç ishin Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan të mbajtura më 19 Maj 2019 dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 6 Tetor 2019.

Për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan të mbajtura më 19 Maj 2019, PZAP-i ka pranuar dhe vendosur për 6 ankesa dhe apele, ndërsa për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura më datën 6 Tetor 2019 PZAP-i, ka pranuar, shqyrtuar dhe vendosur për 514 ankesa/apete. Të gjitha vendimet lidhur me ankesat dhe apelet e parashtruara për procesin zgjedhor janë publikuar në ueb faqen e PZAP-it dhe të njëjtat u janë dorëzuar palëve në kopje fizike.

Në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan të mbajtura më 19 Maj 2019, si rast i rëndësishëm i cili është shqyrtuar dhe vendosur nga Paneli ka qenë apeli Anr.1-2019 i datës 25.04.2019, i paraqitur nga subjekti politik Srpska Lista, kundër vendimit Nr.358/2019 të datës 24.04.2019 të KQZ-së, me të cilin vendim është refuzuar certifikimi i subjektit politik Srpska Lista dhe të 4 kandidatëve të saj për Kryetar të Komunave të theksuara me lartë, edhe për kundër faktit se ZRPPC kishte verifikuar të gjitha dokumentet e këtyre kandidatëve dhe kishte rekomanduar KQZ-në që të bënte certifikimin pasi që i kanë plotësuar kushtet e parapara ligjore. Paneli pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave, mori vendim, që ta **pranoi** pjesërisht si të bazuar apelin e subjektit politik Srpska Lista duke e **anuluar** vendimin e KQZ-së, për arsye se, kandidatët e të njëjtit subjekt politik, i kishin plotësuar kriteret e parapara me ligj, për tu certifikuar dhe **urdhëroi** KQZ-në, që ta certifikoj subjektin politik Srpska Lista dhe kandidatët e këtij subjekti politik për Kryetar të Komunave. Paneli **refuzoi si të pabazuar** pjesën e apelit të këtij subjekti, që kishte të bënte me njoftimin e Prokurorisë kompetente, me pretendimet e apeluesit. se ka pasur elemente të veprës penale në raport me veprimet e anëtarëve të KQZ-së, gjatë procesit të shqyrtimit të rekomandimit dhe marrjes së Vendimit për certifikimin e

subjektit politik, si dhe kandidatëve të këtij subjekti për Kryetar të Komunave, për faktin se, PZAP-i me asnjë dispozitë ligjore, nuk detyrohet që të njoftoj Prokurorinë kompetente, për veprimet dhe qëndrimet e anëtarëve të KQZ-së, gjatë marrjes së vendimeve, sepse është në diskrecionin e secilit anëtarë të KQZ-së, se si të deklarohet dhe të vendos, për një çështje të caktuar. Ndërsa **hudhet si e palejuar** pjesa e apelit të subjektit politik Srpska Lista, me të cilën pretendon, se ky vendimi i KQZ-së, është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe se me këtë vendim, është shkelur e drejta pasive e votimit. Në këtë pjesë të dispozitivit Paneli e ka hudhur si të palejuar pretendimin në ankesë për arsye se, nuk është në juridiksionin e PZAP-it që të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të një organi tjetër të administratës siç është KQZ-ja.

Në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të mbajtura me 6 Tetor 2019, nga rastet më të rëndësishme që u shqyrtuan nga PZAP-i, veçojmë:

Apeli Anr.4/2019 i datës 13.09.2019, i paraqitur nga subjekti politik Srpska Lista, kundër Udhëzimit të KQZ-së Nr.965/2019 të datës 09.09.2019, për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV), i cili udhëzim kishte për qëllim që të udhëzoj anëtarët e KKZ-ve dhe anëtarët e KVV-ve, të cilët merren me organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve, që në ditën e votimit me datë 6 tetor 2019, të pranojnë dokumentet për identifikimin e votuesve në vendvotim, siç është përcaktuar me nenin 90 të Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme si: Letërnjoftimi i vlefshëm, Pasaporta e vlefshme, dokumentet e vlefshme të udhëtimit, leje e vozitjes e vlefshme e Republikës së Kosovës. Paneli pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave mori vendim, që ta refuzoj apelin e apeluesit, duke vlerësuar se vendimi i KQZ-së, në raport me Udhëzimin e lartcekur, ishte i drejtë dhe i ligjshëm dhe se i njëjti ishte marr në zbatim të drejtë të dispozitave të LZP-së, si dhe nuk ia mohan apo cenon të drejtën e votimit askujt dhe nuk është diskriminues për komunitetin serb, siç pretendohet në apel, sepse udhëzimi i apeluar ju referohet të gjithë votuesve të Republikës së Kosovës, jo vetëm një komuniteti.

Apeli Anr.90/2019 e datës 26.09.2019, e paraqitur nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese-BIRN dhe **Apeli Anr.94-2019 të datës 26.09.2019** e paraqitur nga Instituti Demokratik të Kosovës-KDI, kundër subjektit politik Srpska Lista e cila kishte publikuar një video spot zgjedhor, me të cilin bënte cenimin e rendit kushtetues dhe thërriste në juridiksionin e një shteti tjetër, përkatësisht shtetin e Serbisë dhe si i tillë ai video spot përbënte nxitje të urrejtjes për komunitetin shumicë në Kosovë. Paneli, vlerësoi se subjekti politik i lartpërmendur me përdorimin e kësaj gjuhe në video spot, kishte nxitur urrejtje kundrejt tjerëve, me çka kishte bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika (l) të LZP-së, dhe në përputhje me nenin 120 paragrafi 1 pika c) e LZP-së, nenin 3 pika 11, e Rregullores së PZAP-it Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave, i është shqiptuar gjoba në vlerë prej 30,000.00 euro.

Rasti tjetër i rëndësishëm i cili ishte shqyrtuar dhe vendosur nga PZAP-i, ishte **Apeli Anr.375/2019 e datës 17.10.2019** e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje kundër Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të KQZ-së, për shkak të mos procedimit të 4,639 Pakove të Fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës, si fletëvotime të rregullta dhe mos numërimit të të njëjtave në QNR. Subjekti politik LVV kishte pretenduar se me vullnetin e qytetareve të cilët jetojnë jashtë vendit realizohet e drejta Kushtetuese e tyre për të zgjedhur siç parashihet në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të njëjtit kanë legjitimitet të plotë për të kërkuar numërimin e çdo vote të ardhur nga diaspora dhe të dorëzuar në KQZ, e cila do të ndikonte në shtimin e numrit të mandateve dhe do të përfaqësonin interesat ligjore dhe Kushtetuese të më shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pavarësisht se cilit subjekt politik i takonin ato vota. Paneli konstatoi se, pretendimet ankimore për mos numërimin e 4,639 pakove me fletëvotime të ardhura me postë nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë Kosovës, e të cilat ende nuk kishin ardhur dhe numëruar në QNR, nuk mund të ishin objekt i vlerësimit në atë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja ende nuk kishte marrë vendim, lidhur me numërimin e këtyre Pakove të Fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës.

Meqenëse, në rastin konkret nga ana e KQZ-së, nuk ishte marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, paneli vlerësoi se, nuk ishte nën juridiksionin e këtij institucioni, që në atë fazë të procesit të vendoste, lidhur me numërimin e fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës, ngase sipas nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i vendos, vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht në dispozitën e sipërshënuar. Ky Vendim i PZAP-it, me numër Anr.375-2019 i datës 19.10.2019 ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila me Aktgjykimin me nr. A.A.-U.ZH.nr.19/2019 të datës 25.10.2019 kishte **Aprovuar** si të bazuar apelin e subjektit LVV dhe kishte anuluar vendimin e PZAP-it duke ia kthyer lëndën Panelit në rishqyrtim dhe rivendosje, duke pretenduar se Paneli është dashur ta ketë parasysh dispozitën e nenit 127.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore - LPK-së, e cila thotë se në qoftë se parashtrësja është dërguar me anë të postës, dita e dorëzimit në postë konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatë, apo organit të cilit i është drejtuar. Në rishikimin e vendimit të tij Anr.375-2/2019 i datës 28.10.2019, PZAP-i kishte refuzuar apelin e subjektit politik LVV dhe për të njëjtin kishte vendosur si më parë me arsyetimin se, kontestuese mbetet vetëm çështja e vlefshmërisë së pakove me fletëvotime si të rregullta, pasi që në KQZ të njëjtat janë pranuar pas afatit të paraparë ligjor për pranimin e pakove me fletëvotimeve nga votuesit jashtë Kosove. Ndaj këtij vendimi të PZAP-it me numër Anr.375-2/2019, i datës 28.10.2019, subjekti politik LVV kishte parashtruar apel në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila me Aktgjykimin nr. A.A.-U.ZH.nr.20/2019 të datës 30.10.2019 kishte **aprovuar** si të bazuar apelin e subjektit LVV dhe kishte ndryshuar vendimin e PZAP-it Anr.375-2/2019 të datës 28.10.2019, duke urdhëruar kështu KQZ-në që të bëjë rinumërimin e 4,639 pakove të fletëvotimeve të ardhura me postë nga qytetarët të cilët jetojnë jashtë Kosovës, si dhe të njëjtat të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Një apel tjetër i rëndësishëm për këtë proces zgjedhor i shqyrtuar dhe vendosur nga PZAP-i ka qenë **Apeli Anr.386/2019 i datës 8 nëntor 2019** i paraqitur nga disa subjekte politike përfshirë kandidatë dhe votues të tyre, dhe atë: Samostalna Liberalna Stranka (SLS), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Koalicija VAKAT, Lëvizja Vetëvendosje! (VV), Koalicioni NISMA-AKR-PD dhe Partia Liberale Egjiptiane (PLE), apele këto të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me publikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve më datë 07.11.2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 6 tetor 2019, me pretendimet se në këto vendvotime kanë ndodhur disa shkelje apo parregullsi të cilat kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Përkritazi me apelet e paraqitura nga subjektet politike së bashku me kandidatët dhe votuesit e tyre, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të njëjtave, Paneli ka vendosur, që t'i pranojë në tërësi si të bazuara disa prej apeleve të parashtruara për disa vendvotime si dhe të pranojë pjesërisht si të bazuara disa prej apeleve të parashtruara për disa vendvotime dhe kështu ka marrë vendim, me të cilin ka urdhëruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të bëjë rinumërimin e 1,472 vendvotimeve dhe rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në vendvotimet e përshkruara në vendimin e PZAP-it, të përfshihet në rezultatin përfundimtar të këtyre zgjedhjeve. Si dhe me të njëjtin vendim ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar apelet e Koalicijës Vakat, Koalicionit NISMA-AKR-PD dhe Partia Liberale Egjiptiane, lidhur me parregullsitë për disa vendvotime me arsyetimin se, këto vendvotime janë rinumëruar më parë nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

Rasti tjetër i rëndësishëm i shqyrtuar dhe i vendosur nga PZAP-i gjatë procesit zgjedhor 2019, ka qenë **Apeli Anr.428/2019 i datës 07.11.2019**, i paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD, kundër vendimit të KQZ-së nr.1659-2019 të datës 07.11.2019. Në këtë apel pretendohet se vendimi në fjalë ishte në kundërshtim me nenin 97 par. 1 dhe 2 të LZP-së, lidhur me nenet 4.3 dhe 4.4, të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, sa i përket mënyrës së pranimit të Pakove të Fletëvotimeve përmes postës nga votuesit me të drejtë vote e të cilët jetojnë jashtë Kosovës, të dorëzuara nga dy persona të paautorizuar në fahun postal të Kosovës, e që ato pako të fletëvotimeve nuk kishin vulë dhe as pullë postare të postës së origjinës. Pala ankuese i ka propozuar PZAP-it, që t'i shpall të parregullta/pavlefshme 3.782 zarfe të ardhura/bartura nga Serbia, duke kërkuar që i njëjti t'i largojë ato fletëvotime nga rezultati përfundimtar i shpallur me datë 07.11.2019.

Në rastin konkret Paneli të njëjtat i kategorizoi si fletëvotime të pavlefshme duke marrë për bazë që paket me fletëvotime kanë arritur në postën pranuese fizikisht pa vulë të postës dërguese dhe pa pullë postare. Vendimi i lartcekur i PZAP-it ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, nga kandidatët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje për arsye se PZAP-i kishte miratuar ankesën e Koalicionit Nisma-AKR-PD për shkak të shpalljes së pavlefshme të 3782 të pakove të fletëvotimeve të ardhura nga Serbia. Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin e saj A.A 27/2019 të datës 13.11.2019 kishte vërtetuar vendimin e PZAP-it ku kishte refuzuar ankesën e kandidateve nga subjekti politik

LVV, me arsyetimin se të njëjtëve nuk ju është cenuar ndonjë e drejte ligjore dhe kushtetuese. Ndaj po të njëjtit vendim, ishte paraqitur ankesë edhe nga ana e subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka, ku Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin A.A 29/2019 të datës 13.11.2019 ankesën e paraqitur, e kishte hedhur si të palejuar, për shkak të mungesës së interesit ligjor të palës e cila ka paraqitur ankesë, me arsyen se të njëjtës nuk ju është shkelur ndonjë e drejtë themelore, ose ndonjë e drejtë tjetër sa i përket procesit zgjedhor.

Rasti tjetër i rëndësishëm i shqyrtuar dhe i vendosur nga PZAP-i gjatë procesit zgjedhor 2019 ka qenë **Apeli Anr.507/2019**, i paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje! (LVV), me cilin ka kërkuar që të urdhërohet KQZ, që të bëjë verifikimin dhe numërimin e 392 pakove të fletëvotimeve të dorëzuara me post nga votuesit jashtë Kosove, të cilat kanë arritur në fahun postar me datë 19 shator deri me 30 shtator 2019. Apelin e parashtruar nga subjekti politik LVV, Paneli e hodhi të **palejuar** me arsyetimin se, apeli nuk ishte parashtruar pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, të shpallura me datën 07.11.2019, e që pala është dashur që të paraqes apel 24 orë nga momenti i shpalljes të atyre rezultateve, e drejtë kjo të cilën pala nuk e kishte shfrytëzuar në atë kohë. Vendimin në fjalë subjekti politik LVV e kishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, ku e njëjta me Aktgjykimin me nr. A.A.-U.ZH.nr.31/2019 të datës 26.11.2019 kishte **Refuzuar** si të pabazuar apelin e subjektit LVV, ndërsa kishte vërtetuar vendimin e PZAP-it.

Me 2 dhjetor 2019, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në bashkëpunim dhe me përkrahjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë shënoj një ngjarje të rëndësishme duke e bërë promovimin dhe publikimin e **dokumentit të historikut të PZAP-it** për periudhën 2000 – 2017, ngjarje kjo në të cilën morën pjesë përfaqësuesit të institucioneve të Republikës së Kosovës, ambasadori i OSBE-së në Kosovë, përfaqësues tjerë ndërkombëtarë në Kosovë, përfaqësues të subjekteve politike, të OJQ-ve ish anëtarë të PZAP-it, si dhe gazetar të mediave të shkruara dhe atyre elektronike.

Në këtë ngjarje Kryesuesja e PZAP-it znj. Gyltene Sylejmani dhe anëtari i PZAP-it njëkohësisht edhe kryesues i grupit punues për hartimin e këtij dokumenti z. Adnan Konushevci, prezantuan përmbajtjen e dokumentit në të cilin janë të paraqitura informacione për: kompetencat, përbërjen e PZAP-it, administrimin e ankesave dhe apeleve, mënyrën e vendosjes së ankesave dhe apeleve, natyrën e shkeljeve, sanksionet për shkeljet e bëra dhe të dhëna tjera statistikore, për të gjitha proceset zgjedhore në Kosovë nga viti 2000 deri në vitin 2017. Ky dokument, pasqyron punën dhe aktivitetet e PZAP-it, që nga themelimi si dhe arritjet dhe zhvillimin e tij ndër vite, nga viti 2000 deri në vitin 2017 në zgjidhjen dhe vendosjen e kontesteve zgjedhore në Kosovë.

Në këtë ngjarje të rëndësishme një fjalë përshëndetëse dhe falënderuese e paraqiti edhe ambasadori i OSBE-së në Kosovë z. Jan Braathu, i cili vlerësoj arritjet e PZAP-it për këtë periudhë kohore, të cilat arritje janë rezultat i punës profesionale të anëtarëve të PZAP-it dhe të stafit të sekretariatit si dhe falë bashkëpunimit të këtij institucioni me akteret vendor dhe ndërkombëtarë të zgjedhjeve në Kosovë, në

veçanti vlerësoj lartë bashkëpunimin e PZAP-it me Misionin e OSBE-së në Kosovë duke rikonfirmuar mbështetjen e vazhdueshme për PZAP-in në të ardhmen nga ana e OSBE-së, mbështetje kjo e cila nuk ka munguar që nga themelimi i PZAP-it e që vazhdon edhe në ditët e sotme.

Korniza Ligjore – Emërimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Në bazë të nenit 115 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – LZP-së, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Rregullat Zgjedhore.

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-it nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe emëron anëtarët e PZAP-it nga mesi i gjykatësve të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Gjykatave Themelore të Kosovës.

Kryesuesja dhe anëtarët e PZAP-it janë gjyqtar të Gjykatave të lartë theksuara dhe punën e tyre primare e ushtrojnë në këto Gjykata, ndërsa punën e tyre në PZAP e ushtrojnë si punë sekondare, respektivisht puna e tyre në PZAP është e përcaktuar me LZP si mandat shtesë.

Anëtarët dhe kryesuesi i PZAP-it kanë mandat katër (4) vjeçar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa përbëhet nga dhjetë anëtarë përfshi kryesuesen:

1. Gyltene Sylejmani, Kryesuese e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës;
2. Fejzullah Rexhepi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës;
3. Nenad Laziq, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës;
4. Faton Ademi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës;
5. Rrustem Thaqi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës;
6. Zyhdi Haziri, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore - Gjilan;
7. Afijete Sada - Gllogjani, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Themelore - Gjakovë;
8. Adnan Konushevc, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Prishtinë;
9. Kymete Kicaj, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Themelore - Prizren;
10. Ferki Xhaferi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Mitrovicë, Dega në Vushtrri;

Për shkak të përfundimit të mandatit të dytë të anëtarit të PZAP-it z. Rafet Haxhaj, i cili në kuptim të nenit 115.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk ka pasur të drejtë të riemërohet në këtë pozitë, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës me vendimin me numër GJ.A-S.U.A 289-2019 të datës 16-09-2019, në vend të tij ka emëruar si anëtar të PZAP-it z. Ferki Xhaferi, Gjyqtar i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, dega në Vushtrri.



Gyltene Sylejmani,
kryesuese



Fejzullah Rexhepi,
anëtar



Nenad Lazić,
anëtar



Faton Ademi,
anëtar



Rrustem Thaqi,
anëtar



Zyhdi Haziri,
anëtar



Afijete Sada-Gillogjani,
anëtare



Adnan Konushevc,
anëtar



Kymete Kicaj,
anëtare



Ferki Xhaferi,
anëtar

Takimet/Mbledhjet e PZAP-IT

PZAP-i gjatë vitit 2019 ka mbajtur nëntë (9) takime/mbledhje të rregullta mujore në të cilat takime janë shqyrtuar, diskutuar dhe janë marrë 29 vendime që kanë të bëjnë me çështjet administrative të ndërlidhura me organizmin dhe funksionimin e PZAP-it, duke përfshi këtu edhe vendimet për dy proceset e jashtëzakonshme zgjedhore të vitit 2019. Vendimet më kryesore ishin:

- Aprovimi i Raportit Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2018,
- Aprovimi i Planit të Veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, të mbajtura më 19 Maj 2019,
- Aprovimi i Planit të Veprimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 6 Tetor 2019.


Struktura Organizative dhe Burimet Njerëzore të PZAP-IT

Struktura organizative e Institucionit të PZAP-it, përbëhet nga anëtarët e PZAP-it përfshirë kryesuesin, si trup vendimmarrës profesional, dhe nga sekretariati i tij i cili mbështetë punën e PZAP-it në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me LZP.

Me buxhetin e propozuar për vitin 2019, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, PZAP-i ka të lejuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesues të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtar të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të sekretariatit të PZAP-it.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të PZAP-it përfshi kryesuesin është dhjetë (10), ku prej tyre shtatë (7) janë të gjinisë mashkullore ose 70% ndërsa tre (3) janë të gjinisë femërore ose 30%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale nëntë (9) janë shqiptarë ose 90% ndërsa një (1) anëtarë është i përkatësisë Serbe, ose 10%.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Sekretariatit e PZAP-it deri me datën 06.06.2019 ka qenë 10 veta, por për shkak të mos konfirmimit të punës provuese të Drejtorit të Departamentit Ligjor kjo pozite është vakante, ndërsa aktualisht numri i të punësuarve është 9 veta, prej tyre pesë (5) janë të gjinisë mashkullore ose 55% ndërsa katër (4) janë të gjinisë femërore ose 45%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale tetë (8) janë shqiptarë ose 89%, ndërsa një (1) i punësuar është i përkatësisë boshnjake, ose 11%.




Sekretariati i PZAP-IT

Sekretariati i PZAP-it, udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit i cili në bazë të nenit 123.4 të LZP-së, nën drejtimin e kryesuesit të PZAP-it është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretariatit për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e institucionit.

Struktura Organizative e Sekretariatit

- Zyra e Kryesuesit të sekretariatit, të cilën e përbejnë Kryesuesi dhe Asistentja Ekzekutive,
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, i cili përbëhet nga Drejtori i Departamentit, Zyrtari i Përkthimeve Shqip-Serbisht dhe anasjelltas, Zyrtari për Administrimin e Teknologjisë Informative dhe Logjistikë, dhe Zyrtari i Transportit.
- Departamenti Ligjor i cili përbëhet nga Drejtori i Departamentit dhe tre Zyrtarë të Lartë Ligjor.

Organogrami i PZAP-IT



Objektivat e Sekretariatit të PZAP-it të realizuara gjatë vitit 2019

- Gjatë vitit 2019, Sekretariati ishte i përkushtuar në arritjen dhe në përmbushjen me sukses të objektivave dhe aktiviteteve të punës të parapara me Planin e punës për vitin 2019, si dhe me Planin Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016-2019.
- Në mënyrë të veçantë, sekretariati ishte i përqendruar në përgatitjen e materialeve të nevojshme për mbajtjen e seancave të PZAP-it gjatë dy palë zgjedhjeve të jashtëzakonshme në vitin 2019, në përgatitjen e takimeve të rregullta të PZAP-it, në finalizimin e dokumentit të Buletinit të PZAP-it - Botimi i dytë, në finalizimin e dokumentit të Historikut të PZAP-it për periudhën kohore 2000-2017, në aftësimin dhe në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve profesionale të personelit dhe në zhvillimin, në hartimin e në zbatimin e mëtejme të rregullave dhe të procedurave të punës, për të siguruar një performancë sa më të lartë të sekretariatit, brenda përgjegjësi që ka.
- Përmbushja e objektivave të identifikuar është fryt i punës ekipore të personelit të sekretariatit me mbështetjen e fuqishme të kryesueses dhe anëtarëve të PZAP-it, si dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Publikimet e Sekretariatit të PZAP-it në Ueb faqen e tij

- Raporti vjetor për vitin 2018 në gjuhën shqipe dhe Serbe;
- Plani i punës për vitin 2019.
- Buletini i PZAP-it - Vëllimi II,
- Historiku i PZAP-it për periudhën 2000-2017,
- Vendimet lidhur me 6 ankesa dhe apele të paraqitura për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Mitrovicën e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviç të mbajtura më datë 19 Maj 2019, si dhe vendimet lidhur me 514 ankesa dhe apele të paraqitura për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 6 Tetor 2019, dhe
- Te gjitha dokumentet e rëndësishme të PZAP-it.

Sekretariati për takimet e PZAP-it ka përgatitur dhe prezantuar për shqyrtim, diskutim dhe vendosje materialet e nevojshme për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it:

- Procesverbalet e takimeve/ mbledhjeve të PZAP-it,
- Raportet tremujore të punës së PZAP-it,
- Draft Raportin e punës së PZAP-it për vitin 2018,
- Planin e veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetarë të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, të mbajtura më datë 19 maj 2019,

- Planin e veprimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 06 Tetor 2019,
- Planin e punës për vitin 2019,
- Draft Rregulloren e PZAP-it për Procedurën e Shqyrtimit dhe vendosjen e ankesave,
- Draft Rregulloren e PZAP-it për përshkrimin e detyrave të punës dhe klasifikimin e vendeve të punës,
- Finalizimi i Draft Buletinit të PZAP-it vëllimi II,
- Finalizimi i Draft Historikut të PZAP-it 2000-2017,
- Çështjet e personelit të sekretariatit,
- Çështjet e prokurimit,
- Çështjet e buxhetit dhe të financave,
- Çështje të teknologjisë informative dhe logjistikës,
- Çështje të transportit.

Gjithashtu në përputhje me mandatin e përcaktuar me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it ka marrë 41 vendime për çështjet që ndërlidhën me funksionimin e institucionit dhe atë:

Formimin e Komisioneve për hapjen e ofertave, vlerësimin e ofertave, pranimin e mallit, caktimin e menaxhereve për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e kontratave të tenderëve, vlerësimin dhe tjetërsimin e pasurisë etj..

Në kuadër të kompetencave të tij kryesuesi i sekretariatit ka nënshkruar 3 (tri) Marrëveshje të Mirëkuptimit me Komisionin Qendrorë Zgjedhor dhe atë:

- Për huazimin e Zyrtarit të Prokurimit të KQZ-së për të kryer punët e prokurimit për PZAP,
- Për huazimin e zyrtarit certifikues të PZAP-it për të kryer punët e certifikimit për KQZ,
- Për huazimin e zyrtarit shpenzues të PZAP-it për të kryer punët e shpenzimeve për KQZ.

Këto huazime janë bërë për kohë të caktuar për shkak të mungesës së zyrtarëve për kryerjen e këtyre punëve brenda KQZ-së dhe PZAP-it deri në zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Një (1) Marrëveshje të Mirëkuptimit PZAP-i ka nënshkruar me Policinë e Kosovës (PK) për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike, si dhe sigurimin fizik brenda objektit në hyrje të PZAP-it.

Formimin e komisioneve të ndryshme.

Punëtoritë, Trajnimet dhe Vizitat Zyrtare Jashtë Vendlit

Punëtoritë e PZAP-it

Me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të stafit, rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punë, PZAP-i gjatë vitit 2019 ka mbajtur 3 punëtori. Dy (2) punëtori janë mbështetur me buxhet të institucionit, ndërsa një është mbështetur me buxhet të OSBE-së.

Punëtoritë e parë e mbajtur nga data 27-31 Mars 2019

Punëtoritë e parë është mbajtur në Durrës nga data 27-31 Mars 2019 në të cilën punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesen, personeli i sekretariatit të PZAP-it, ish- Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe përfaqësuesit nga OSBE-ja. Në këtë punëtori janë diskutuar tema dhe çështje si më poshtë:

- Progresi i punës së Grupit punues për Hartimin e Dokumentit të Historikut të PZAP-it për periudhën kohore 2000-2017;
- Shqyrtimi dhe diskutimi i Draft Rregullores së PZAP-it për Procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave dhe apeleve;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të PZAP-it për vitin 2018;
- Shqyrtimi dhe diskutimi i Draft Rregullores së PZAP-it për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Punëtoritë e dytë e mbajtur nga data 06-09 Qershor 2019- Hartimi i dokumentit të Historikut të PZAP-it

Punëtoritë e dytë është mbajtur në Durrës nga data 06-09 Qershor 2019 në të cilën punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e grupit punues të Historikut të PZAP-it dhe kryetari i komisionit të përhershëm për çështje ligjore të PZAP-it. Në këtë punëtori është shqyrtuar dhe diskutuar tema si më poshtë:

- Hartimin e Dokumentit të Historikut të PZAP-it për gjatë viteve 2000 – 2017 dhe i njëjti është finalizuar si dokument.

Punëtoritë e organizuar nga OSBE-ja nga data 04-06 Dhjetor 2019:

Punëtoritë e tretë është mbajtur në Durrës nga data 04-06 Dhjetor 2019, në të cilën punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesen si dhe dy ish anëtarët e PZAP-it, Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit, personeli i sekretariatit të PZAP-it, si dhe përfaqësuesit nga OSBE-ja.

Në këtë punëtori janë diskutuar tema dhe çështje si më poshtë:

- Vlerësimi i përgjithshëm i performancës së PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 6 Tetorit 2019;
- Vlerësimi i çështjeve të zgjedhjeve (paraqitja e të dhënave statistikore të ankesave dhe apeleve të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 11 qershor 2017, si dhe krahasimi i të dhënave statistikore të ankesave dhe apeleve me Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019);
- Planifikimi, ndarja e buxhetit dhe realizimi i tij gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 6 Tetor 2019 si dhe të hyrat e realizuara nga gjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike nga PZAP-i;
- Vlerësimi i performancës së PZAP-it në komunikim me mediat dhe aktet tjerë gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 6 Tetor 2019;
- Vlerësimi i performancës së PZAP-it në përgatitjen dhe arsyetimin e vendimeve gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 6 Tetorit 2019;
- Vlerësimi i performancës së PZAP-it në zbatimin e afateve ligjore në marrjen e vendimeve lidhur me ankesat dhe apelet për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 6 Tetorit 2019.

Trajnimet e PZAP-it

Personeli i Sekretariatit gjatë vitit 2019 kanë marrë pjesë në disa trajnime dhe punëtori të organizuara me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale. Trajnimet dhe punëtoritë e organizuara deri më tani kanë qenë si në vijim:

- Pjesëmarrje e stafit të sekretariatit në takimin me IFES për Vlerësimin e Riskut dhe Planin për Menaxhim të Rreziqeve, të mbajtur me datat 09 dhe 10 Janar 2019.
- Pjesëmarrje në takimin me IFES-in, për rishikimin/vlerësimin e zbatimit të Strategjisë së PZAP-it, të mbajtur me datat 22 dhe 23 Janar 2019.
- Pjesëmarrja e Drejtorit të Departamentit Ligjor, në trajnimin me temën: Auditimi i Burimeve Njerëzore të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike - IKAP, të mbajtur me datat 5 dhe 7 shkurt 2019.
- Pjesëmarrja e Zyrtarit të Lartë Ligjor në trajnimin me temën: Kodi Etik, të Drejtat dhe Përgjegjësit në Shërbimin Civil të Kosovës – SHCK, të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike - IKAP të mbajtur me datat 13-14 mars 2019.
- Pjesëmarrja e Drejtorit të Departamentit Ligjor, në trajnimin me temën: Menaxhimi i programit punë jetë të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike - IKAP, të mbajtur me datat 18 dhe 19 prill 2019.

- Pjesëmarrja e Zyrtares së Lartë Ligjore, në trajnimin me temën: Planifikimi, menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike – IKAP, të mbajtur me datat 19-20 qershor 2019.
- Pjesëmarrja e Zyrtarit të IT dhe zyrtarit të përkthimeve në trajnimin me temën: Menaxhimi i pasurive përmes SIMFK dhe E-pasuria, të organizuara nga Prudencia Konsulting me datat 21-24 qershor 2019.
- Pjesëmarrja e Zyrtares së Lartë Ligjore, në trajnimin Sistemi për mbrojtjen e të dhënave personale të mbajtur me datat 18 dhe 19 nëntor 2019.
- Pjesëmarrja e U.D Zyrtares së Lartë Ligjore, në trajnimin Qasja në Dokumente Publike të mbajtur me datën 12 dhe 13 dhjetor 2019.

Vizitat zyrtare jashtë vendit

Vizita në Finlandë nga data 13 Prill 2019 deri me 16 Prill 2019.

- Një delegacion i PZAP-it i përbërë prej pesë (5) anëtarëve me qëllim të vëzhgimit të Zgjedhjeve Parlamentare të cilat janë mbajtur me 14 prill 2019 në Finlandë, ka realizuar vizitën zyrtare nga data 13 Prill 2019 deri me 16 Prill 2019.
- Vizita është planifikuar me Planin Vjetor të Punës dhe kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të Institucionit, përfitimin e njohurive dhe shkëmbimin e përvojave me institucionet e Finlandës të cilat merren me organizimin zgjedhjeve dhe zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, respektivisht mbrojtjen e të drejtës së votës.
- Përbërja e delegacionit të PZAP-se ishte si në vijim: Gyltene Sylejmani – Kryesuese e PZAP-it, anëtarët e PZAP-it: Rafet Haxhaj, Fejzullah Rexhepi, Faton Ademi dhe Kymete Kicaj.

Vizita në Bosnjë dhe Hercegovinë –Sarajevë nga data 30 shtator-1 tetor

- Vizita në fjalë është planifikuar pas ftesës së bërë nga ana e IFES-i për PZAP-in me të cilën kanë kërkuar që në takimin e ardhshëm të Rrjetit të Jurisprudencës Rajonale të Evropës dhe Euro Azisë të marrë pjesë një përfaqësues nga institucioni i PZAP-it në konferencën e cila do të mbahet nga data 30 shtator deri me datën 1 tetor në Sarajevë të Bosnje dhe Hercegovinë. Ftesa është dërguar nga Dr. Beata Martin-Rozumiłowicz - Drejtor për Evropën dhe Euro Azinë.
- Si përfaqësues nga PZAP-i për pjesëmarrje në këtë vizitë dhe këtë takim ishte anëtari i PZAP-it, Zyhdi Haziri.

Aktiviteti i Grupit Punues për hartimin e Buletinit të PZAP-it II

Në vitin 2019 grupi punues për hartimin e buletinit të PZAP-it ka bërë përgatitjen dhe finalizimin përfundimtar të Buletinit me vendime të PZAP-it - Vëllimi i II për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2017, si dhe ato të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2017.

Në këtë vëllim është bërë përzgjedhja e 38 vendimeve të PZAP-it të cilat përmbajnë rastet më të veçuara dhe më të rëndësishme të vendimeve për të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe pas zgjedhor përfshirë rastet e vendimeve që kanë të bëjnë me ankesat dhe apelet e subjekteve politike, kandidatëve për deputet për Kuvend të Republikës së Kosovës, kandidateve për Kryetar të Komunave dhe kandidateve për anëtar të Kuvendeve Komunale, Organizatave Jo Qeveritare, qytetarëve, etj.

Grupi Punues për hartimin e Historikut të PZAP-it 2000 - 2017

Grupi Punues për hartimin e dokumentit të Historikut të PZAP-it për periudhën 2000 – 2017, gjatë vitit 2019, ka mbajtur pesë (5) takime të rregullta ku janë analizuar dhe diskutuar aktivitetet e grupit punues lidhur me finalizimin e këtij dokumenti. Në këto takime janë caktuar prioritetet e grupit punues për takimet e radhës për kryerjen e këtyre aktiviteteve, si dhe është diskutuar organizimi i një punëtorie për finalizimin e dokumentit të Historikut të PZAP.

Me qëllim të finalizimit të dokumentit të historikut PZAP-i anëtarët e grupit punues kanë organizuar një punëtori në Durrës të Shqipërisë e cila është mbajtur nga data 06-09. 06. 2019 ku në këtë punëtori është shqyrtuar dhe diskutuar materiali i përgatitur nga ana e grupit punues për Hartimin e Dokumentit të Historikut të PZAP-it për gjatë viteve 2000-2017 dhe është finalizuar draft dokumenti në tërësi.

Departamenti Ligjor

Aktivitetet e zyrtarëve të Departamentit Ligjor kanë qenë si në vijim:

- Draftimi i Rregullores së PZAP-it për Komunikim me Shkresa, me vonë e titulluar si Rregullore për Shqyrtim dhe Vendosjen e Ankesave dhe Apeleve sipas rekomandimit të Komisionit për Legjislacion;
- Draftimi i Rregullores për Përshkrimin e Detyrave dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës për nëpunësit civil të SPZAP-it;
- Përpilimi i propozimeve për përmbardim të vendimeve të PZAP-it tek përmbarduesi privat për subjektet politike të cilat nuk i kanë paguar gjrobat;
- Përpilimi i kërkesave për aprovimin e shpenzimeve për përmbardimin e vendimeve të PZAP-it;
- Përpilimi i kërkesës për inicim të proceduarve të prokurimit lidhur me botimin e Buletinit të PZAP-it;
- Pjesëmarrje në komision për vlerësimin e ofertave për Buletin II të PZAP-it;
- Përgatitja e raporteve mujore të punës lidhur me aktivitetet e kryera të Departamentit Ligjor të cilat janë prezantuar në takimet e rregullta të SPZAP-it;
- Pjesëmarrje e zyrtarëve të departamentit në takimet e Sekretariatit të PZAP-it;
- Pjesëmarrja e zyrtarëve të lartë ligjor në takimet e PZAP-it në cilësinë e procesmbajtësit të takimeve gjatë punëtorive dhe gjatë takimeve të rregullta të PZAP-it si dhe njoftimi i anëtarëve dhe kryesueses së PZAP-it me procesverbalet e këtyre takimeve;
- Përgatitja e të gjitha materialeve fizike për takimet e PZAP-it;
- Përgatitja e informatave të Raporteve mujore dhe tremujore për vitin 2019;
- Pranimi, protokollimi skanimi i ankesave dhe apeleve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan. që janë mbajtur me datën 19 maj 2019 dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtur me datën 6 Tetor 2019;
- Hartimi, referimi i draft vendimeve për Panelin e PZAP-it si dhe ofrimi i ndihmës së nevojshme të panelit;
- Pjesëmarrja e zyrtarëve ligjor në takimet e organizuara nga grupi punues për hartimin e Historikut të PZAP-it, dhe përgatitja e materialëve fizike për këto punëtori, përgatitje të agjendave, etj;
- Hulumtimi dhe nxjerrja e të dhënave për kryerjen e detyrave të caktuara nga grupi punues për hartimin e Historikut të PZAP-it;
- Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga IKAP;
- Shkëmbimi i informacioneve në mes të Departamentit ligjor të SPZAP-it, me zyrtarët e ZRPPC/KQZ lidhur me informatat e nevojshme për procesin zgjedhor për Zgjedhjet e

Jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që janë mbajtur me datën 19 maj 2019 dhe për procesin zgjedhor për Zgjedhjet të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 6 Tetor 2019;

- Pjesëmarrje në komisionet për vlerësimin e ofertave, për menaxhimin e kontratave si dhe për pranimin e mallrave për nevoja të PZAP-it;
- Futja e të dhënave në sistemin e menaxhimit të ankesave dhe apeleve që janë në përgjegjësi të zyrtarit ligjor;
- Pjesëmarrja e zyrtarëve ligjor në hetimin e rasteve në QNR për shkeljet përkitazi me numërimin e fletëvotimeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 6 Tetor 2019.

Aktivitetet lidhur me çështjet e personelit të Sekretariatit të PZAP-it

- Përditësimi i dosjeve personale fizike dhe elektronike të personelit të SPZAP-it, me të gjitha dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit të nëpunësit civil si: formularët e pushimeve vjetore, format për kompensimin e orëve shtese, formularët e vlerësimit të punës për vitin 2018 etj.
- Pjesëmarrje në trajnimin për vijueshmërinë elektronike për personel (SMVP), në MAP.
- Përgatitja e formularëve përmbledhës të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018 për personelin e SPZAP-it, në bashkëpunim me Kryesuesin e SPZAP-it, dhe dërgimi i të njëjtit në DASHC/MAP.
- Ri – rregullimi i dosjeve fizike të personelit të SPZAP-it.
- Menaxhimi i vijueshmërisë së personelit të sekretariatit në punë përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Vijueshmërisë së Personelit, SMVP Janar - Dhjetor 2019,
- Planifikimi i pushimeve vjetore të personelit në SIMBNJ,
- Evidentimi i pushimeve vjetore të zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it.
- Pjesëmarrje në takimin me Drejtorët e Departamenteve dhe zyrtarët e SPZAP-it, lidhur me identifikimin e nevojave për trajnim për vitin 2019.
- Dërgimi i Draft Planit të trajnimeve për personelin e SPZAP-it, Kryesuesit të Sekretariatit për rishikim dhe aprovim.
- Dërgimi i Formularëve për Pagesën e Pushimit Prindor në MAP për Zyrtaren e lartë Ligjore.
- Sipas kërkesës së auditorëve dërgimi i dokumenteve në dosje personale fizike, përmes email-it, kompensimet për punë jashtë orarit, përmes USB dokumente të dosjes personale, Plani Individual i Personelit, tabela të pagave, dosjes së rekrutimit dhe dokumente tjera për personelin e SPZAP-it.

- Dërgimi në MAP i Planit vjetor të trajnimeve për vitin 2019, personelin e SPZAP-it.
- Plotësimi i të dhënave në modulën e statistikave për NC të SPZAP-it në SIMBNJ.
- Plotësimi i formularit për trajnim dhe financim të trajnimeve dhe dërgimi i të njëjtit sipas kërkesës në MAP.
- Njoftim i zyrtareve të lartë publik të institucionit, lidhur me listën e zyrtareve të lartë, sipas kërkesës nga AKK.
- Plotësimi dhe dërgimi i listës me emrat e zyrtareve të lartë publik të SPZAP-it në AKK.
- Njoftimi i zyrtareve të lartë publik të institucionit për deklarimin e pasurisë sipas kërkesës nga AKK.
- Njoftim i AKK për pranimin e dhuratave për vitin 2018.
- Përgatitja dhe dorëzimi i shkresës në AKK, lidhur me caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim sipas kërkesës së AKK-së në bazë të ligjit Nr.06/L-085, 15.03.2019.
- Përditësimi i dosjeve personale fizike dhe elektronike dhe SIMBNJ të personelit të SPZAP-it me të gjitha dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit të nëpunësit civil si: Formularët e pushimeve vjetore, Format për kompensimin e orëve shtesë,
- Dërgimi i formularëve dhe dokumenteve tjera për pagesa në divizionin e pagave në MF-MAP, etj.
- Kërkesë drejtuar kryesuesit për vlerësimin e punës provuese për drejtorin e DL të SPZAP-it.
- Njoftim i drejtorit të DL për takimin e punës provuese.
- Njoftimi i drejtorit të DL me vendimin për mos konfirmimin e punës provuese dhe formularit të vlerësimit të punës provuese në mënyrë fizike dhe elektronike.
- Njoftim i drejtorit të DL për shfrytëzimin dhe mos shfrytëzimin e pushimit vjetor.
- Përgatitja e vërtetimit të marrëdhënies së punës për DL.
- Menaxhimi i ftesave për trajnim, njoftimi i drejtoreshave të departamenteve, dhe konfirmimi i pjesëmarrjes në trajnim në IKAP për zyrtarët e caktuar.
- Ofrimi i bashkëpunimit të nevojshëm sipas kërkesës së auditorit për çështjet e personelit,
- Njoftim i drejtorit të DL lidhur me vendimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave.
- Bashkëpunimi me Agjencinë Kundër Korrupsion - AKK-në në cilësinë e personit kontaktues dhe njoftimi i drejtorit të DL për deklarimin e pasurisë pas përfundimit të marrëdhënies së punës.
- Bashkëpunimi me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - KPMSHC lidhur me pranimin e kërkesave për përgjigje, lidhur me ankesat e parashtruara nga drejtori i DL, kompletimi i lëndës dhe dorëzimi në KPMSHC.

- Përgatitja dhe menaxhimi i orarit të kujdestarisë për muajt prill dhe maj 2019 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në komunat Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.
- Evidentimi i pushimeve vjetore të zyrtareve të Sekretariatit të PZAP-it.
- Dërgimi i njoftimit drejtuar zyrtares së SPZAP-it për përzgjedhjen si shërbyes civil me i mire nga PZAP-i për vitin 2018, si dhe pjesëmarrja në takimin e organizuar nga MAP për nder të ditës së shërbyesve civil të datës 23 qershor 2019, i cili takim është mbajtur me 21 qershor 2019.
- Zhvillimi i të gjitha procedurave për rekrutimin e zyrtareve jo permanent për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, Shtator 2019.
- Përgatitja dhe menaxhimi i orarit të kujdestarisë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të 6 tetorit 2019.

Aktivitetet lidhur me certifikimin e shpenzimeve financiare për nevoja të PZAP-it

- Aprovimi i shpenzimeve të realizuara për të gjitha kontratat e lidhura me operatorët ekonomik (shpenzimet e telefonisë fikse, telefonisë mobile, për ujë të pijshëm, për mirëmbajtje dhe pastrimin e zyrave të PZAP-it, për karburantet e veturave të PZAP-it, TV kabllor dhe internet, dhe sigurimet e automjeteve).
- Aprovimi i shpenzimeve lidhur me pagesat për përmbarimin e vendimeve me titull ekzekutiv.
- Aprovimi i shpenzimeve të realizuara për punëtoritë dhe udhëtimet e organizuara brenda dhe jashtë vendit.
- Aprovimi i shpenzimeve të realizuara për shtypjen e Buletinit II, Pajisjeve të TI-kompjuterëve, shpenzimet për furnizim me formularë në gjuhën shqipe, serbe dhe turke, si dhe shpenzimet për furnizim me formularë në gjuhën Brail për persona me aftësi të kufizuara për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 6 tetorit 2019.
- Aprovimi i shpenzimeve të realizuara për kontrata për shërbime të veçanta për stafin e përkohshëm jo permanent të angazhuar për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, 6 tetor 2019.
- Aprovimi dhe mbyllja e avanseve për shpenzimet e realizuara për udhëtimin zyrtar jashtë vendit.
- Mbyllja e petty- cashit për shpenzimet e realizuara.
- Aprovimi i shpenzimeve tjera të ndryshme të realizuara për nevoja të ndryshme për institucionin e PZAP-it.

Aktivitetet e Prokurimit për nevoja të PZAP-it

- Përgatitja e Planifikimit Paraprak të Prokurimit Publik të PZAP-it për vitin 2019;
- Përgatitja e raportit për kontratat e nënshkruara të PZAP-it për vitin 2019 dhe dorëzimi në Komisionin Rregullativ të Prokurimit (KRPP);
- Nënshkrimi i kontratës së tenderit për Botimin e Buletinit II (përkthimin, dizajnimin dhe printimin), dhe pranimi i dokumentit të Buletinit nga punëkryesi;
- Nënshkrimi i kontratës së tenderit për blerjen dhe montimi i derës në akses kontroll në katin përdhës të PZAP-it, pranimi i mallit dhe punëve të kryera nga punë kryesi.
- Inicimi dhe zhvillimi i procedurës së Prokurimit për sigurimin Kasko të automjeteve të PZAP-it;
- Si aktivitet tjetër me rëndësi në Prokurimin Publik të PZAP-it, ka qenë urdhër blerja për të gjitha kontratat që kemi të lidhura me Operatoret Ekonomik;
- Nënshkrimi i kontratës së tenderit për blerjen dhe furnizimin me Pajisjeve të TI-kompjuterëve.
- Inicimi dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit për përkthimin e Historikut të PZAP-it në gjuhën angleze;
- Dorëzimi në mënyrë fizike dhe elektronike i Planit Final të Prokurimit Publik për vitin 2019 në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP);
- Përgatitja e një raporti me të dhënat e të gjitha kontratave valide që ka nënshkruar PZAP-i me operatorët ekonomik;
- Menaxhimi i kontratës me titull Furnizim me karburante për automjete të PZAP-it;
- Lidhja e kontratës për furnizim me formularë në gjuhët zyrtare (shqip, serbisht dhe turqisht) për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të 6 tetorit 2019;
- Lidhja e kontratës për furnizim me formularë në gjuhën Brail për persona me aftësi të kufizuara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 6 tetorit 2019;
- Zhvillimi i procedurës së Prokurimit për furnizim me aparat për ngrohje të zyrave të institucionit të PZAP-it.

Bashkëpunimi i PZAP-it me akterët e zgjedhjeve

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2016, në mes të aktereve të zgjedhjeve, PZAP-it, KQZ-së, Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, PZAP ka implementuar të gjitha objektivat dhe aktivitetet e parapara në bazë të këtij Memorandumi. Niveli i bashkëpunimit me akteret e këtij memorandumi është ngritur gjatë Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave për Komunitet e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut si dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 6 Tetor 2019. Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në mes të akterëve të zgjedhjeve

nënshkrues të Memorandumit janë mbajtur takime të rregullta në të cilat takime zyrtaret përgjegjës të këtyre institucioneve kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbarëvajtjen e dy proceseve zgjedhore të mbajtura në vitin 2019.

Bashkëpunimi me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE

PZAP-i ka një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe profesional me Misionin e OSBE-së në Kosovë. OSBE i ka ofruar PZAP-it mbështetje në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit përmes organizmit të punëtorive si dhe ka përkrahur PZAP-in në projektin e dokumentit të historikut të PZAP-it për periudhën 2000-2019.

Janë shkëmbyer informata dhe statistika gjatë gjithë procesit zgjedhor të vitit 2019, lidhur me numrin e ankesave që janë paraqitur në PZAP, natyrat e ankesave, shqyrtimi dhe vendosja e tyre nga Paneli,.

OSBE përveç mbështetjes financiare që i ka ofruar PZAP-it në përgatitjen dhe botimin e dokumentit të historikut të PZAP-it për periudhën 2000 - 2017 ka mbuluar edhe të gjitha shpenzimet e takimit të PZAP-it të mbajtur me datën 02.12.2019 me rastin e promovimit të këtij dokumenti të mbajtur në Hotelin Sirius në Prishtinë ku ishin të ftuar mysafir të ndryshëm nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues nga subjektet të ndryshme politike, përfaqësues të organizatave të ndryshme jo qeveritare, përfaqësues të mediave etj..

OSBE ka mbështetur financiarisht punëtorinë e PZAP-it të mbajtur nga data 04 – 06. 12. 2019, në Strugë të Maqedonisë së Veriut me temën mësimet e nxëna ku është diskutuar për gjetjet kryesore nga monitorimi i rregullt i performancës së PZAP-it, gjatë vitit 2019. Në këtë punëtori janë nxjerr dhe janë identifikuar çështje dhe probleme ku ka nevojë dhe duhet që të përmirësohen si dhe është diskutuar për objektivat dhe aktivitete me kryesore që duhet të jenë të përfshira me Planin vetor të Punës së PZAP-it për vitin 2019.

Bashkëpunimi i PZAP-it me Fondacionin Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore – IFES

Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore - IFES-i me 21 shkurt 2019 i ka përmbyllur aktivitetet e përkrahjes për institucionet e zgjedhjeve në Kosovë. Deri në këtë kohë kemi zhvilluar një bashkëpunim shumë të mire. Janë mbajtur disa punëtori të përbashkëta me qëllim të hartimit të dokumenteve si:

- Hartimi i dokumentit për Vlerësimin e Riskut dhe Plani për Menaxhim të Rreziqeve për institucionin e PZAP-it.
- Hartimin e dokumentit për rishikimin/vlerësimin e zbatimit të Strategjisë së PZAP-it.

Transparenca - Komunikimi dhe Informimi Publik

Transparenca me Misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë për Vëzhgimin e Zgjedhjeve - MBEVZ

PZAP-i ka qenë transparent dhe i ka ofruar qasje Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve - MBEVZ në Kosovës në të gjitha informatat e kërkuara nga ky mision për numri i ankesave që janë paraqitur dhe vendosur nga PZAP gjatë procesit të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, natyrën e ankesave, dhe informata tjera statistikore të këtyre zgjedhjeve.

PZAP-i me përfaqësuesin e MBEVZ në Kosovë i cili ka qenë i autorizuar për vëzhgimin e procesit ankimorë në PZAP kanë mbajtur takime sipas nevojës në të cilat takime janë shkëmbyer informata lidhur me ankesat dhe apelet e vendosura nga PZAP-i për këtë procese zgjedhor.

Përfaqësuesi i këtij misioni është njoftuar nga PZAP-i dhe sipas mundësive të tij ai ka marrë pjesë në disa seanca të mbajtura nga Paneli i PZAP-i me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave dhe apeleve të paraqitura gjatë zgjedhjeve, etj..

Komunikimi me media dhe me publikun

Gjatë vitit 2019, mediat elektronike të shkruara dhe portalet kryesisht kanë qenë të interesuara për qasje në informatat lidhur procesin zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 Tetor 2019.

Të gjitha mediave në kohën me optimale ju janë dhënë informatat/përgjigjet lidhur me pyetjet e parashtruara.

Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it Mulë Desku, është autorizuar nga PZAP-it për të komunikuar me mediat elektronike dhe të shkruara për ti njoftuar ato dhe përmes tyre opinionin publik me gjitha punët dhe aktivitetet e rëndësishme të PZAP-it gjatë procesit zgjedhor të 6 Tetorit 2019 prej fillimit e deri në përfundimin e këtij procesi zgjedhor.

Në zbatim të autorizimeve të dhëna nga PZAP-i, kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it ka marrë pjesë dhe ka dhënë intervista në disa emisione televizive në Radio Televizionin e Kosovës - RTK, Koha Vizion – KTV, TV Tribuna, T7 etj.. Përmes paraqitjeve në këto emisione kryesuesi i Sekretariatit ka njoftuar publikun me aktivitetet e planifikuara dhe të kryera nga PZAP-i për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 Tetorit 2019.

PZAP-i ka informuar publikun me të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur në institucionin e PZAP-it gjatë procesit zgjedhor të vitit 2019 dhe atë me numrin e ankesave të paraqitura, vendosjen e tyre,

sanksionet dhe gjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike dhe ndalimi nga PZAP-i që ju është bërë anëtarëve të Këshillave të vendotimeve dhe vëzhguesve për moskryerjen e detyrave të tyre në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme – LZP gjatë ditës së zgjedhjeve.

Të gjitha mediave të Kosovës, elektronike dhe të shkruara, iu është dhënë mundësia që të kenë qasje në të gjitha informatat e kërkuara për të gjitha aktivitetet e kryera nga PZAP-i për zgjedhjet e mbajtura në vitin 2019.

Përpos atyre që u përmendën më lart PZAP-i ka publikuar në faqen zyrtare të saj në formë elektronike dokumentet e finalizuar: Buletinin - vëllimi II me vendimet e PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura në vitin 2017 dhe Zgjedhjet Komunale për Kryetar të Komunave të vitit 2017, si dhe Dokumentin e Historikut të PZAP-it përgjatë viteve 2000-2017.

Tryezat e organizuara nga Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D)

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D)

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë, ka përgatitur një udhëzues për proceset zgjedhore i cili kishte për synim të ofrojë disa informata bazike për proceset zgjedhore dhe njëkohësisht, do t'iu mundësonte palëve të interesuara aplikim më të lehtë të dispozitave ligjore apo rregulloreve për aspekte të caktuara të zgjedhjeve.

Institucionet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nënshkruan memorandumit e bashkëpunimit për procesin zgjedhor në shkurt të vitit 2016. Arritja e këtij memorandumit është mbështetur dhe koordinuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D).

Për përgatitjen e këtij udhëzuesi informativ, Instituti D4D ka organizuar disa punëtori me përfaqësuesit e institucioneve nënshkruese të Memorandumit si dhe me stafin profesional teknik për hartimin e udhëzuesit.

- **Takimi i parë është mbajtur me datë 12 mars 2019, në ora 11:30, në Prishtinë.**

Në këtë takim, Instituti D4D ka organizuar një drekë pune, për një konsultim paraprak, me të gjithë udhëheqësit e institucioneve të lartcekura.

Në takim është diskutuar për mundësinë që ky udhëzues të ketë pronësinë e institucioneve nënshkruese të memorandumit si dhe për aspekte të përgjithshme të materies që do duhej të përmbante ky dokument.

Pas takimi konsultativ, secili institucion ka deleguar një përfaqësues/koordinator për të marrë pjesë në grupin punues deri në finalizimin e udhëzuesit. Nga PZAP-i ka qenë i deleguar kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it Mulë Desku i cili ka marrë pjesë në të gjitha takimet dhe punëtoritë e organizuara nga D4D për përgatitjen e aspektit teknik të udhëzuesit informativ.

- **Takimi i dytë është mbajtur me datë 19 mars 2019, në ora 11:30, në Prishtinë.**

Me qëllim të finalizimit të punës në Udhëzuesin për proceset zgjedhore, D4D ka filluar me takimet e grupit punues.

Takimi i parë është mbajtur të martën, më 2 prill 2019, në ora 10:00, në Prishtinë.

Takimi i dytë është mbajtur të mërkurën më 10 prill 2019, në ora 10:00 në Prishtinë.

Takimi i tretë është mbajtur të mërkurën më 17 prill 2019, në ora 10:00 në Prishtinë.

Takimi i katërt është mbajtur të premten më 03 maj 2019, ora 10:00 në Prishtinë.

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), në Hotel Radika, Mavrovë të Maqedonisë Veriore nga datat 13-15 qershor 2019 ka organizuar punëtorinë “Drejtësia zgjedhore dhe koordinimi ndër-institucional në mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore”.

Nga PZAP-i, në këtë punëtori kanë marrë pjesë kryesuesja e PZAP-it znj. Gyltene Sylejmani dhe dy zyrtar të administratës së sekretariatit Mulë Desku dhe Kudret Hasani. Gjithashtu në punëtori kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Institucioneve nënshkruese të memorandumit dhe stafi i administratës së tyre.

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), në Tiranë të Republikës së Shqipërisë nga datat 13-15 dhjetor 2019 ka organizuar punëtorinë e radhës “Drejtësia zgjedhore dhe koordinimi ndër-institucional në mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore”, ku në këtë punëtori kanë marrë pjesë përfaqësuesit nga institucionet nënshkruese të Memorandumit të Bashkëpunimit e që janë akter të zgjedhjeve në Kosovë.

Nga PZAP-i, në këtë punëtori kanë marrë pjesë kryesuesja e PZAP-it znj. Gyltene Sylejmani dhe kryesuesi i sekretariatit z. Mulë Desku

Takimi me subjekte politike dhe me përfaqësuesit e OJQ-ve

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) pranë Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ-së) me datën 23 shtator 2019 kanë mbajtur takim informativ me akterët kryesor të zgjedhjeve në Kosovë.

Pjesë e këtij takimi kanë qenë personat kontaktues të subjekteve politike të certifikuara (koalicionet, partitë politike, dhe kandidatët e pavarur) për të marr pjesë në zgjedhje, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile që fokus kanë zgjedhjet si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që kontribuojnë në fushën e zgjedhjeve në Kosovë.

Qëllimi i takimi ishte shkëmbimi i ndërsjelli i informatave si dhe diskutimi i mënyrave se si të bëhet përmirësimi i komunikimit të ndërsjellë të akterve të zgjedhjeve me fokus të veçantë në respektimin e kodit të mirësjelljes dhe zbatimit në plotni të legjislacionit që ndërlidhet me zgjedhjet në Kosovë.

PZAP dhe KQZ kanë bashkëbiseduar me subjektet politike dhe organizata e shoqërisë civile në lidhje me atë se çka mundet PZAP dhe KQZ të bëj më shumë për zbatimin e ligjit dhe sigurimit të një atmosfere për zgjedhje të lira dhe demokratike.

Panelistët në këtë takim, kanë qenë anëtarët e PZAP-it z. Faton Ademi, dhe Z. Adnan Konushevc si dhe Yll Buleshkaj, Drejtor Ekzekutiv i ZRPPC-së - KQZ-së.

Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë përfaqësuesit e 15 subjekteve politike dhe 10 OJQ-ve.

Qëllimi i këtij takimi ishte që të ju rikujtojmë subjekteve politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët për të kontribuar në krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Subjektet politike, janë këshilluar se, ato mund të organizojnë çfarëdo tubimi ose fjalimi politik, mbledhje, prezantim publik, ose ndonjë aktivitet të përgatitur për të përçar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet. Por, subjektet politike janë të obliguara të respektojnë Kodin e

Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme - LZP-së dhe Rregullën nr. 13 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve-KQZ që rregullojnë Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimet për Ngjarjet Politike. Pjesëmarrësit janë informuar dhe rikujtuar se, kjo kornizë ligjore vendos rregullat bazë për të drejtat për fushatë zgjedhore, por edhe atë se çka mund të përdoret si material i fushatës, vendet e lejuara dhe të ndaluara për fushatë, kohen dhe vendin ku duhet të dërgohet njoftimi për mbajtjen e tubimit politik.

Shpërndarja e Formularëve të Ankesave:

PZAP-i për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 6 Tetorit 2019, në të gjitha Komisionet Komunale të Zgjedhjeve në 38 Komuna të Kosovës, ka bërë shpërndarjen e Formularëve të ankesave në të tri gjuhët: shqip, serbisht dhe turqisht. Formularët janë dorëzuar në Zyrat Komunale të Zgjedhjeve, ku Zyrtarët e Lartë të Komisioneve Komunale Zgjedhore i kanë shpërndarë në Qendrat e Votimit në ditën e zgjedhjeve.

Ne Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës janë shpërndarë 30,435 formularë te ankesave: 23,470 ne gjuhen shqipe, 5,955 ne gjuhen Srpska dhe 1,010 ne gjuhen turke.

Me qëllim të krijimit të kushteve të barabarte për të gjithë qytetarët e Kosovës në paraqitjen e parregullsive eventuale dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre gjatë zgjedhjeve, PZAP-i, ka përgatitur Formularë të ankesave në alfabetin Brail për personat e verbër, ku janë shpërndarë gjithsejtë 445 formularë te ankesave, nga ato 340 ne gjuhen shqipe, 70 ne gjuhen Srpska dhe 35 ne gjuhen turke.

Dorëzimi i Formularëve të ankesave në alfabetin brail është bërë në një takim të mbajtur në selinë e PZAP-i, të mbajtur me përfaqësuesit e Shoqatës së të verbërve të Kosovës me stafin e Sekretariatit të PZAP-it.

Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan

Pas marrjes së vendimit të datës 08.04.2019, nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës për caktimin dhe shpalljen e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan të cilat janë mbajtur me 19 maj 2019, PZAP-i ka përgatitur dhe miratuar planin e veprimit për këtë proces zgjedhor. PZAP-i, gjatë këtij procesi zgjedhore ka organizuar kujdestarin, respektivisht ka caktuar dhe realizuar orarin e punë shtesë për stafin e sekretariatit.

PZAP-i, ka mbajtur takime dhe kontakte të rregullta me personat kontaktues me akterët e zgjedhjeve gjatë gjithë procesit zgjedhor.

Për këtë proces zgjedhor PZAP-i ka pranuar gjithsej 5 ankesa dhe 1 apel.

Para fushatës zgjedhore ka pranuar 1 apel me natyrën e lëndës mos certifikimit të subjektit politik, të parashtruar nga subjekti politik Srpska Lista.

Gjatë fushatës zgjedhore PZAP-i ka pranuar 3 ankesa nga organizata joqeveritare KDI për shkak të vendosjes së pllakateve në rrugë dhe hapësira publike, si dhe vendosja e posterave në shtylla elektrike. Për ditën e votimit ka pranuar 2 ankesa nga organizata joqeveritare BIRN dhe IKS me natyrën e lëndës, parregullsi gjatë procesit të votimit si dhe mospërputhje të numrit të nënshkrimeve me fletëvotime dhe me pretendimet për votimin e qytetareve me dokumente te shtetit tjetër.

Sa i përket mënyrës se marrjes se vendimeve lidhur me këto lende PZAP-i ka vendosur që një (1) apel e ka pranuar pjesërisht si të bazuar, ndërsa lidhur me tri (3) ankesat i ka pranuar si të bazuara, një (1) ankese e ka hedhur si te parregullt, ndërsa një (1) ankese eshët refuzuar si e pabazuar.

Sa i përket parashtrimin të ankesave nga komunat i kemi statistikuar si në vijim:

Një (1) apel dhe tri (3) ankesa janë paraqitur nga komuna e Mitrovicës së Veriut,

Një (1) ankesë është paraqitur nga komuna e Zubin Potokut dhe

Një (1) ankesë është nga komuna e Zveçanit

Gjatë këtij procesi zgjedhor janë mbajtur dy seanca për vendosjen e ankesave.

Apelet e parashtruara në PZAP nga Subjektet Politike jashtë procesit zgjedhor, respektivisht kur nuk ka pasur zgjedhje

Gjatë vitit 2019 në PZAP janë parashtruar edhe pesë apele të cilat nuk kanë pasur të bëjnë me dy proceset zgjedhore të vitit 2019:

Apelet e paraqitura janë kryesisht ndaj vendimeve të KQZ-së si:

Apeli: Anr. 87/2019 i datës 26.06.2019 i paraqitur nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, përkitazi me heshtjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për moszbatimin e vendimeve të KQZ-së Nr. 1230-2017 datë 08.07.2017, Nr. 104-2018 datë 22.01.2018 dhe vendimit Nr. 195-2019 datë 28.03.2019, për ndarjen e mjeteve nga fondi për mbështetje të subjekteve politike në mes të koalicionit parazgjedhor LDK-AKR për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi lejueshmërinë e paraqitjes së apelit, gjeti se Apeli është i palejuar pasi që natyra e ankimit të parashtruar me apel nuk hyn në shkaqet e përcaktuara me nenin 122 paragrafi 1 të Ligjit Nr 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe neni 15 Ligji Nr.03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin Nr 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të LZP-së, për të cilat mundë të apelohe vendimet e KQZ-së në PZAP.

Apeli: Anr. 7/2019 i datës 19.07.2019 i paraqitur nga subjekti politik Partia Balliste (PB) me seli në Prishtinë, për shkak të mos regjistrimit të këtij subjekti politik në regjistrin e partive politike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi lejueshmërinë e paraqitjes së apelit, gjeti se apeli është i bazuar duke e anuluar vendimin e KQZ-se dhe të njëjtin e ka kthyer në rishikim dhe vendosje, pasi që nga shkresat e lëndës ka rezultuar se subjekti politik në fjale i ka plotësuar kushtet ligjore për tu regjistruar në regjistrin e partive politike.

Apelet: Anr.515/2019, Anr.516/2019, dhe Anr.517/2019 të datës 05.12.2019, të parashtruara nga subjektet politike Nova Snaga (NS), Partia e të Gjelbërve të Kosovës (PGJK), si dhe apeli i paraqitur nga subjekti politik Partia Republikane e Kosovës (PRK), që të gjitha këto apele të paraqitura ndaj vendimeve të KQZ-së për shkak të çregjistrimit të këtyre subjekteve nga regjistri i partive politike të regjistruara në KQZ.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi lejueshmërinë e paraqitjes së apeleve, gjeti se apelet janë të pabazuara dhe të njëjtat me vendime veç e veç i refuzoi si të pabazuara duke i lënë në fuqi vendimet e KQZ-së për çregjistrimin e këtyre subjekteve nga regjistri i partive politike.

Njoftimi i PZAP-it nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës me kërkesat e parashtruara në këtë Gjykatë dhe Aktvendimet e Gjykatës lidhur me këto raste

PZAP-i është njoftuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me kërkesat e parashtruara në këtë Gjykatë nga disa subjekte politike dhe kandidatë për Kryetar të Komunave në zgjedhjet e vitit 2017 dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura në vitin 2019, me të cilat kërkesa është kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të KQZ-së, PZAP-it dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me rastet e vendosura nga këto institucione në zgjedhjet e vitit 2017 dhe vitin 2019, si dhe është njoftuar me aktvendimet lidhur me këto raste.

Kërkesa KI59/18 datë 30 prill 2018

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka njoftuar PZAP-in me kërkesën KI59/18 datë 30 prill 2018, të parashtruar në këtë Gjykatë nga Strahinja Spasic, kandidatit për Kryetar të Komunës së Klllokotit, nga subjekti politik Srpska Lista, dega në Klllokot për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it ZL. Anr. 1112/2017 të datës 27.11.2017, Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 58/2017 të datës 01.12.2017 dhe Vendimit të PZAP-it ZL.Anr. 1127/2017 të datës 08.12.2017, si dhe Vendimit të Kontestuar të Komisionit Qendror Zgjedhor Nr. 2585/17 të datës 14.12.2017, lidhur me parregullsitë në procesin e numërimit të votave të dërguara me post, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19 nëntor 2017.

Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI59/18 datë 30.04.2018

Gjykata Kushtetuese me Aktvendimin për Papranueshmëri Nr.ref.:718/19rl të datës 15 prill 2019 ka vendosur që ta deklaroj të papranueshme kërkesën në rastin nr. KI59/18 datë 30.04.2018, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 58/2017 të datës 01.12.2017 dhe Vendimit të PZAP-it ZL.Anr. 1127/2017 të datës 08.12.2017, si dhe Vendimit të Kontestuar të Komisionit Qendror Zgjedhor Nr. 2585/17 të datës 14.12.2017

Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme sepse është e paafatshme dhe ka vendosur ta deklaroj kërkesën të papranueshme.

Kërkesa KI01/18 datë 5 janar 2018

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka njoftuar PZAP-in me kërkesën KI01/18 të datës 5 janar 2018, të parashtruar nga Gani Dreshaj, kandidatit për Kryetar të Komunës së Istogut, nga

subjekti politik AAK, dega në Istog, për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it ZL. Anr. 1142/2017 të datës 23.12.2018, dhe Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 64/2017 të datës 26.12.2017, lidhur me parregullsi në procesin e numërimit të votave të dërguara me post, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19 nëntor 2017.

Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI01/18 datë 5 janar 2018

Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktvendimin për Papranueshmëri Nr.ref.:1323/19rl të datës 4 shkurt 2019 ka vendosur që ta deklaroj të papranueshme kërkesën në rastin nr. KI01/18 datë 5 janar 2018, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 64/2017 të datës 26.12.2017 dhe Vendimit të PZAP-it ZL.Anr. 1142/2017 të datës 23.12.2017.

Kërkesa KI148/18 datë 27 prill 2018

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka njoftuar PZAP-in me kërkesën KI148/18 datë 27 prill 2018, të parashtruar nga Arban Abrashi, kandidatit për Kryetar të Komunës së Prishtinës, nga subjekti politik LDK, dega në Prishtinë, për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it ZL. Anr. 1125/2017 të datës 07.12.2017, Aktvendimet të Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 52/2017 të datës 25.11.2017 dhe Aktvendimet të Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 62/2017 të datës 07.12.2017, lidhur me parregullsitë e ndodhura, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19 nëntor 2017.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI148/18 datë 27 prill 2018

Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktgjykimin me Nr.ref.:1322/19rl të datës 04 shkurt 2019 ka vendosur që ta deklaroj të papranueshme kërkesën në rastin nr. KI148/18 datë 27 prill 2019, në lidhje me Aktvendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 52/2017 të datës 25.11.2017 dhe AA-UZ nr. 62/2017 të datës 07.12.2017 dhe Vendimit të PZAP-it ZL.Anr. 1125/2017 të datës 07.12.2017.

Kërkesa KI207/19 datë 25 nëntor 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka njoftuar PZAP-in me kërkesën KI207/19 datë 25 nëntor 2019, të parashtruar nga koalicioni NISMA-AKR-PD e cila konteston dy Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 20/2019 të datës 30.10.2019 dhe AA-UZ nr. 21/2019 të datës 05.11.2019, lidhur me urdhërimin e KQZ-së për numërimin e 4,639 pako të fletëvotimeve te votave të ardhura me post nga diaspora.


Përmbledhje e informatave dhe të dhëna statistikore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend Të Republikës Së Kosovës Të Mbajtura Me 6 Tetor 2019

Prej shpalljes së zgjedhjeve me datën 26 Gusht 2019 deri me datën 27 Nëntor 2019, respektivisht deri me përfundimin e afatit për paraqitjen ankesave dhe apeleve për të gjitha fazat e procesit zgjedhor, të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 Tetor 2019, në PZAP janë parashtruar - gjithsejtë: 514 ankesa dhe apele dhe të cilat janë shqyrtuar dhe vendosur nga PZAP-i brenda afatit ligjor. PZAP-i të gjitha palëve ju ka dorëzuar vendimet lidhur me ankesat dhe apelet e parashtruara në mënyrë fizike brenda afatit ligjor si dhe të gjitha ankesa dhe apelet së bashku me shkresat e lëndës i ka arkivuar në mënyrë fizike dhe elektronike.

Këto ankesa dhe apele i takojnë periudhës së zgjedhjeve të para fushatës, fushatës zgjedhore, ditës së heshtjes zgjedhore, ditës së zgjedhjeve, ankesa lidhur me shpalljen e rezultateve preliminare dhe apele lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ-ja.


Ne tabelën e mëposhtë është paraqitur numri i ankesave dhe apeleve të parashtruara në PZAP sipas fazave Procesit Zgjedhor:

Nr.	Fazat e procesit zgjedhor	Numri i ankesave	Numri i apeleve
1	Para fushatës zgjedhore	3	86
2	Gjatë fushatës zgjedhore	151	1
3	Thyerjen e heshtjes zgjedhore	99	0
4	Ditën e votimit	33	0
5	Rezultatet preliminare	4	5
6	Ankesat lidhur me administrimin në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR)	30	0
7	Ankesat lidhur me Rezultatet Përfundimtare	5	97
Totali		325	189



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat të cilat pasqyrojnë meritat e marrjes së vendimeve nga PZAP-i lidhur me ankesat dhe apelet të parashtruara

Nr	Mënyra e marrjes së vendimeve:	Ankesa
1	Të miratuara si të bazuara	194
2	Të refuzuar si të pabazuara	181
3	Të hedhur si të palejuara	78
4	Të hedhur si të pasafatshme	41
5	Të hedhur si të parregullta	20
6	Të tërhequra	1
Totali:		514



Ankesat dhe apelet e paraqitura dhe të vendosura nga PZAP-i pas publikimit të Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve nga KQZ-ja me datën 07.11.2019.

PZAP-i ka shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesat dhe apelet e parashtruara nga kandidatet për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës brenda afatit ligjor prej 72 orëve prej momentit të shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve .

Gjithsejtë janë paraqitur dhe PZAP-i ka vendosur për 102 apele.

Subjekti Politik	Nr. i ankesave	Të miratuara	Të refuzuara	Të pasafatshme	Të Palejuara	E tërhequr
JGP	1	0	1	0	0	0
KDTP	1	0	0	1	0	0
LDK	23	15	7	0	1	0
LVV	6	3	2	0	0	1
NDS	1	0	1	0	0	0
Nisma-AKR-PD	6	2	3	0	1	0

PAI	1	0	1	0	0	0
PDAK	1	0	1	0	0	0
PDK	12	4	8	0	0	0
PG	1	0	1	0	0	0
PKS	4	0	0	4	0	0
PLE	2	1	0	0	1	0
SLS	42	23	2	17	0	0
Koalicioni Vakat	1	1	0	0	0	0
Gjithsejtë	102	49	27	22	3	1

Ankesat e hetuara në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR – KQZ

Nga ekipet e hetueseve të kryesuar nga anëtarët e PZAP-it, dhe me pjesëmarrjen e zyrtareve të administratës së Sekretariatit kanë bërë hetim në QNR me pretendimet ankimore të ankuesve për mospërputhje të rezultateve në Formularët e Përputhjes së Rezultateve – FPR dhe Formularët e Rezultateve të Kandidateve – FRK, lidhur me 30 ankesa për 62 kuti të votimit.

Nga hetimi ka rezultuar se 11 ankesa janë pranuar të bazuara, 2 ankesa janë pranuar pjesërisht të bazuara, 15 ankesa janë refuzuar të pabazuara dhe, 1 ankese është hudhur e pasafatshme, 1 ankese e Lëvizjes Vetëvendosje për numërimin e 392, pakove me fletëvotime të dorëzuara me postë nga votuesit jashtë Kosovës është hudhur e pasafatshme.

PZAP-i, ka marrë vendim që 15 personave në cilësinë e Kryesuesve, Anëtareve dhe vëzhguesve të Vendvotimeve të ju ndaloj të drejtën për 5 vite që të jenë pjesë administrative e zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja, në zgjedhjet e ardhshme Lokale apo Parlamentare, dhe për të njëjtët raste për këta persona është njoftuar Prokuroria e Shtetit për kompetence të mëtejme.

Ankesat/Apelet e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës:

Gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 Tetor 2019, palët e pa kënaqura me vendimet e PZAP-it, kanë ushtruar të drejtën e tyre ligjore dhe i kanë apeluar vendimet e PZAP-it në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

Në Gjykatën Supreme të Kosovës janë paraqitur 27 ankesa kundër vendimeve të PZAP-it, prej të cilave 22 ankesa janë refuzuar ndërsa 5 ankesa janë miratuar.

Natyrat e vendimeve të PZAP-it, të cilat janë ankimuar në Gjykatën Supreme të Kosovës, janë si në vijim:

- Kundër Udhëzimit të KQZ-së 965/2019, për identifikimin e votuesve në vendvotime;
- Për shkak të mos nominimeve të anëtarëve të subjektit të tyre në KVV;

- Për shkak gjobës së shqiptuar në vlerë prej 2.500 euro;
- Për shkak gjobës së shqiptuar në vlerë prej 6000 euro;
- Për shkak të paqartësisë së dispozitivit të vendimeve PZAP-it;
- Vendosje e posterit në shtyllë elektrike në vende publike;
- Për përfshirjen e personit privat pa lejen e tij në aktivitetin promovues zgjedhor;
- Për shkak të humbjes së disa fletëvotimeve në ditën e votimit;
- Për shkak të mos procedimit të 4,639 fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës si fletëvotime të rregullta dhe mos numërimit të të njëjtave në QNR;
- Për shkak të ndarjes së vendeve të garantuara për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Për shkak të shpalljes të pavlefshme të 3782 te pakove të fletëvotimeve të ardhura nga Serbia;
- Lidhur me rezultatet përfundimtare;
- Lidhur me ndarjen e vendeve të garantuara për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian;
- Lidhur me numërimin e 392 pako të fletëvotimeve të ardhura me poste.

Me poshtë gjeni listën me Rastet e Apeluara në Gjykatën Supreme të Kosovës:

1. Vendim i PZAP-it Anr. 4/2019, i datës 11.09.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.3/2019,
2. Vendim i PZAP-it Anr. 84/2019, i datës 24.09.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.4/2019,
3. Vendim i PZAP-it Anr. 98/2019, i datës 27.09.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.7/2019,
4. Vendim i PZAP-it Anr. 99/2019, i datës 27.09.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.6/2019,
5. Vendim i PZAP-it Anr. 100/2019, i datës 27.09.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.5/2019,
6. Vendim i PZAP-it Anr. 118/2019, i datës 30.09.2019, është ndryshuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.8/2019,
7. Vendim i PZAP-it Anr. 118/2019, i datës 30.09.2010 është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.17/2019,
8. Vendim i PZAP-it Anr. 139/2019, i datës 02.10.2019, është ndryshuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.10/2019,
9. Vendim i PZAP-it Anr. 148/2019, i datës 02.10.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.9/2019,
10. Vendim i PZAP-it Anr. 166/2019, i datës 04.10.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.15/2019,
11. Vendim i PZAP-it Anr. 167/2019, i datës 04.10.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.14/2019,

12. Vendim i PZAP-it Anr. 168/2019, I datës 04.10.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.13/2019,
13. Vendim i PZAP-it Anr. 177/2019, i datës 04.10.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.12/2019,
14. Vendim i PZAP-it Anr. 182/2019, i datës 04.10.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.11/2019,
15. Vendim i PZAP-it Anr. 233/2019, I datës 06.10.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.16/2019
16. Vendim i PZAP-it Anr. 344/2019, i datës 10.10.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.18/2019
17. Vendim i PZAP-it Anr. 375/2019, i datës 19.10.2019, është ndryshuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.19/2019
18. Vendim i PZAP-it Anr. 375-2/2019, i datës 28.10.2019, është ndryshuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.20/2019
19. Vendim i PZAP-it Anr. 381/2019, i datës 03.11.2019, është ndryshuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.21/2019
20. Vendim i PZAP-it Anr. 427/2019, i datës 09.11.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.28/2019
21. Vendim i PZAP-it Anr. 428/2019, i datës 10.11.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.29/2019, dhe A.A.nr.27/2019
22. Vendim i PZAP-it Anr. 448-/2019, i datës 09.11.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.24/2019
23. Vendim i PZAP-it Anr. 450/2019, i datës 08.11.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.23/2019
24. Vendim i PZAP-it Anr. 461/2019, i datës 10.11.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.25/2019,
25. Vendim i PZAP-it Anr. 482/2019, i datës 09.11.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.26/2019,
26. Vendim i PZAP-it Anr. 326/2019, i datës 07.10.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.30/2019
27. Vendim i PZAP-it Anr. 507/2019, i datës 24.11.2019, është vërtetuar me Vendimin e Gj. Supreme A.A.nr.31/2019

Vendime të PZAP-it të apeluara në Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjithsejtë: 27 vendime

Vendime të PZAP-it të vërtetuara nga Gjykata Supreme të Kosovës, Gjithsejtë: 22 vendime

Vendime të PZAP-it të ndryshuara nga Gjykata Supreme të Kosovës, Gjithsejtë 5 vendime.


Natyra e ankesave dhe apeleve të zgjedhjeve të 6 Tetorit 2019

Nr	Natyra e ankesave	Nr. i ankesave
1	Anulimi i pakove me fletëvotime të ardhura me post nga Serbia	1
2	Bërja e fushatës në afërsi të vendvotimit	1
3	Bërja e fushatës zgjedhore	2
4	Bërja e fushatës zgjedhore pa leje	1
5	Dëmtim i posterëve	2
6	Ekspozimi i fletushkave për LVV në objektin shkollor	1
7	Falsifikimi i nënshkrimeve për votuesit jashtë Kosovës	1
8	Fletëvotimet me Postë jashtë Kosovës nuk janë dorëzuar në mënyrë të duhur	1
9	Fotografim i votës	1
10	Gabime në plotësimin e FPR	8
11	Humbja e Fletëvotimeve	2
12	Keq përdorimi i emrit të SP	1
13	Kërkesa për tërheqje nga lista e kandidatëve për deputet	6
14	Kërkim i votës përmes telefonit	1
15	Kundër Udhëzimit të KQZ-se	1
16	Llogaritja në FRK gabim	23
17	Mbajtja e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për mbajtjen e saj si dhe përdorimi i fëmijëve për fushatë	1
18	Mbyllja e zyrave të SP afër QV	1
19	Mos emërimi i anëtarëve në KVV-ve	3
20	Mos emërimi i anëtarëve në KKZ	2
21	Mos largimi i posterit gjatë heshtjes zgjedhore në afërsi të qendrës së votimit	4
22	Mos lejimi i mbajtjes së tubimit zgjedhor	2
23	Mos lejimi i votimit në qendrën përkatëse	1
24	Mos numërimi i votave jashtë Kosovës	4
25	Mos përfshirja e votuesit në listën e votimit jashtë Kosovës.	74
26	Mos përfshirja në listën përfundimtare të votuesve.	2
27	Mos përputhje e nënshkrimeve në LPV me fletëvotime	5
28	Mos përputhje e votave të SP me kandidatin	1
29	Mospërputhja e nënshkrimeve me LPV	1
30	Mospërputhje e rezultateve	1
31	Mungesa e votave	29
32	Ndryshimi rezultatit pas rinumërimit nga KQZ	8

33	Nuk janë shpërndarë votat e kandidateve	1
34	Numërimi i votave me kusht	1
35	Nxitje dhe provokim	1
36	Parregullsi për fletëvotimet jashtë Kosovës	1
37	Parregullsi gjatë ditës së votimit	3
38	Parregullsi gjatë numërimit	3
39	Parregullsi në QNR	30
40	Parregullsi gjatë numërimit në QNR	1
41	Parregullsi lidhur me votat e ardhura nga Serbia	2
42	Për shkak të gabimit në FPR	18
43	Përdorim i fëmijëve në Fushatë Zgjedhore	25
44	Përdorim i gjuhës së urrejtjes	9
45	Përdorimi i pjesëtarëve të institucioneve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore	11
46	Përfundim nga Vendvotimi	2
47	Për shkak ndarjeve të ulëseve në Kuvend	1
48	Për shkak të parregullsive në ditën e votimit dhe ndikimi tek rezultati final	16
49	Postimi i materialit promovues në rrjete sociale gjatë heshtjes zgjedhore	49
50	Postimi i reklamave aktive në rrjete sociale	19
51	Presion ndaj votuesve për të votuar subjektin e caktuar politik.	2
52	Rinumërim i votave	1
53	Rinumërim nga votuesit jashtë Kosovës	1
54	Shfrytëzimi i hapësirave publike	1
55	Shfrytëzimi i pozitës publike me qëllim përfitimit të votave	1
56	Shkelja e Kodit Mirësjelljes	1
57	Shpallja e fletëvotimeve të pavlefshme	1
58	Shpërndarja e materialit në afërsi të vendvotimeve	6
59	Shpërndarja e ulëseve në Kuvend	1
60	Shpërndarja e videos të tubimit politik	1
61	Thirrje për votim përmes rrjeteve sociale	7
62	Thirrje për votim përmes SMS-ve	2
63	Thyerja e heshtjes zgjedhore	4
64	Transmetimi i spotit politik publicitar-RTK	1
65	Vendosja e flamujve në shtylla të ndriçimit publik	1
66	Vendosja e flamujve në hapësirë publike	1
67	Vendosja e posterave në afërsi të qendrës së votimit	6


68	Vendosja e posterave në trafo publike	2
69	Vendosja e posterëve dhe banerëve mbi rrugë publike	2
70	Vendosja e postereve mbi ndërtesë publike dhe private	1
71	Vendosja e postereve në automjete private	1
72	Vendosja e posterëve në rrugë publike	1
73	Vendosja e posterëve/billbordit dhe materialit propagandues në afërsi të shkollës	8
74	Vendosja e posterëve/billbordit dhe materialit propagandues në vende publike	42
75	Vendosja e posterit në afërsi të objektit fetar	1
76	Vendosja e posterit në objekte publike	7
77	Vendosja e posterit në pronë private	2
78	Vendosja e posterit në shtyllë elektrike	5
79	Vendosja e shtandit në rrugë publike	5
80	Vendosja e tavolinës me postera të kandidatëve në rrugë publike	2
81	Vendosja e tendës dhe shtandit me materiale propaganduese në hapësirë publike	5
82	Vendosja e tendës me materiale propaganduese në rrugë publike	7
Total		514

Nr. i ankesave




Parashtruesit e ankesave/apelve në zgjedhjet e 6 Tetorit 2019

Nr.	Ankuesi	Nr. i ankesave
1	AAK-PSD	7
2	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	1
3	BIRN dhe IKS	103
4	Busines Center	1
5	OJQ Ec Më Ndryshe	1
6	Emin Beqiri	1
7	Ertan Simitqi	1
8	ESDAK	1
9	Fjala	2
10	GIG	2
11	IRDK	4
12	JGP	1
13	KDI	33
14	KDTP	3
15	LDK	68
16	Srpska Lista	2
17	LVV	62
18	NDS	1
19	NISMA-AKR-PD	43
20	Organizata Gremin	2
21	PAI	1
22	PDAK	2
23	PDK	28
24	PEK	4
25	PG	1
26	PKS	9
27	PLE	10
28	Policia e Kosovës	1
29	PRK	1
30	SLS	43
31	Snezhana Jovanoviq	1
32	VAKAT	1
33	Votues Jashtë Kosovës	73
Total		514




Kryerësit e supozuar në Zgjedhjet e 6 Tetorit 2019

Nr.	Kryerësi i supozuar	Nr. Ankesave
1	AAK-PSD	41
2	IRDK	5
3	JGP	2
4	KDTP	2
5	KQZ, KKZ, KVV	253
6	Koalicioni Sllloboda	1
7	LDK	47
8	Lëvizja për Drejtësi	1
9	Srpska Lista	16
10	LVV	52
11	MTS	1
12	NISMA-AKR-PD	17
13	PDK	65
14	PEK	3
15	PG	2
16	PLE	4
17	PREBK	1
18	VAKAT	1
Total		514



Ankesat e parashtruara sipas komunave ku kanë ndodhur shkeljet gjatë Zgjedhjeve të 6 Tetorit 2019

Nr.	Komuna	Nr. i ankesave
1	Dragash	6
2	Drenas	3
3	Ferizaj	24
4	Fushë Kosovë	8
5	Gjakovë	9
6	Gjilan	9
7	Graçanicë	39
8	Istog	1
9	Junik	2
10	Klllokot	1
11	Klinë	2
12	Leposaviq	8
13	Lipjan	3
14	Malishevë	3
15	Mamushë	1
16	Mitrovicë	16
17	Obiliq	1
18	Partesh	1
19	Pejë	10
20	Podujevë	3
21	Prishtinë	236
22	Prizren	26
23	Rahovec	3
24	Ranillug	1
25	Shtërpçë	2
26	Shtime	3
27	Skenderaj	6
28	Suharekë	1
29	Viti	6
30	Zveçan	2
31	Vushtrri	5
32	Votues Jashtë Kosovës	73
Total		514



PZAP-i ka shqiptuar gjoba ndaj subjekteve politike për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes të LZP-së gjatë fushatës zgjedhore dhe thyerjes së heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 6 tetorit 2019, në shumë prej gjithsejtë: **360,000.00 euro**

1. Partia Demokratike e Kosovës – PDK	100,100.00 euro,
2. Koalicioni AAK-PSD	89,600.00 euro,
3. Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK	74,850.00 euro,
4. Srpska Lista	36,500.00 euro,
5. Koalicioni Nisma- AKR- PD	33,900.00 euro,
6. Lëvizja Vetëvendosje	14,100.00 euro,
7. Koalicioni Sloboda	5,100.00 euro,
8. IRDK	1,200.00 euro,
9. KDTP	1,100.00 euro,
10. PG	1,100.00 euro.
11. PLE	1,100.00 euro,
12. VAKAT	1,100.00 euro,
13. PREBK	250.00 euro,

Gjithsejtë gjoba: 360,000.00 euro

Rastet e dorëzuara në Zyrën e Prokurorit të Shtetit

1. Rasti Anr. 90/2019, paraqitur nga BIRN dhe IKS, paraqitur ndaj Listës Srpska për shkak se e njëjta gjate fushatës zgjedhore nëpërmjet video spotit ka përdorur gjuhës të urrejtjes dhe ka bërë presionit për të votuar subjektin e tyre politik.
2. Rasti Anr. 127/2019, paraqitur nga subjekti politik LVV kundër koalicionit NISMA-AKR-PD për shkak se në komunën e Prishtinës militantët e këtij koalicioni duke shpërndarë gjera ushqimore, duke ndikuar dhe duke bërë presion ndaj votuesve për të votuar subjektin e tyre politik.
3. Rasti Anr. 151/2019, paraqitur nga subjekti politik PKS kundër Nenad Georgijev- Tuta dhe Sekulij Bojan, për shkak se në fshatin Kamenica komuna Leposaviq, të njëjtit në mënyrë të vazhdueshme kanë dëmtuar posterët e subjektit politik PKS
4. Rasti Anr. 214/2019, ka të bëjë me atë pasi që në emër të OJQ Ec Më Ndryshe persona të panjohur në mënyrë të rrejshme ka paraqitur ankesë ndaj disa subjekteve te ndryshme politike, për shkak se të njëjtit ashtu siç pretendohej kanë vendosur postera/billborde dhe materiale propaganduese në vendet publike në qytetin e Prizrenit.

5. Rasti Anr. 313/2019, paraqitur nga subjekti politik LVV kundër subjektit politik LDK, me të cilën theksohet se në komunën e Istogut, subjekti politik në fjalë ka detyruar votuesit që të votojnë votën e tyre duke ju premtuar shpërblime financiare në të holla.
6. Rasti Anr. 344/2019, paraqitur nga Xhevdet Smakiqi nga Koalicioni NISMA-AKR-PD kundër komisionerëve në vendvotimet për shkak të humbjes së fletëvotimeve në Shkollën “Shotë Galica në fshatin Runik, Komuna e Skenderajt
7. Rasti Anr. 366/2019, paraqitur nga subjekti politik PKS për shkak të parregullsive të paraqitura gjatë ditës nga ana e kryesuesve dhe anëtarëve të vendvotimeve: 1203b, 1207b/01D, 1202b/01r, 1201/02R në Komunën e Leposaviqit.
8. Rasti Anr. 383/2019, paraqitur nga subjekti politik SLS kundër kryesuesve dhe anëtarëve të vendvotimeve Qendrat e votimit QV 3805X, 3804B, 3805B, 3806B, QV 3703D, QV 3601D, Vendvotimet VV 2304D/01R, VV 2308D/01R, VV 2308D/01R, VV 2303D/03R, VV 2304D/02D Komunitet Mitrovica e Veriut, Klllokot, Partesh të paraqitur për shkak të parregullsive në ditën e votimit dhe ndikimi tek rezultati final.
9. Rasti Anr. 416/2019, paraqitur nga subjekti politik SLS paraqitur kundër KQZ-së për shkak të falsifikimit të nënshkrimeve për votat e ardhura nga Serbia.

Raporti i Buxhetit dhe Shpenzimeve Vjetore për Vitin Fiskal - 2019

Hyrje

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0160. PZAP-i financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2019 përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-48) dhe SNKSP dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimit të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë në sistemin e kesh-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€).

Shumat raportuese janë në njësi në €.

Buxheti i Planifikuar Dhe Aprovuar për vitin – 2019

Me ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-133 për vitin 2019 për Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndarë buxhet në shumë prej 218,588€. Gjatë vitit 2019 janë mbajtur dy palë Zgjedhje, Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet; Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zvečan, të mbajtura me datën 19 maj 2019 si dhe Zgjedhje e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 tetor-2019.

Pas shpalljes së këtyre dy palë zgjedhjeve nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës, PZAP-i në zbatim të mandatit të tij të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme - LZP-së menjëherë ka thirrur dhe mbajtur takimet e jashtëzakonshme me anëtarët dhe kryesuesen e PZAP-it si dhe stafin e sekretariatit të PZAP-it me qëllim të marrjes së vendimeve për të planifikuar aktivitetet për këto Zgjedhje. Një ndër aktivitetet kyçe ishte edhe planifikimi i buxhetit për këto zgjedhje. Bazë për planifikimin e buxhetit për mbajtjen e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune dhe për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare kanë shërbyer analizat e shpenzimeve të realizuara në zgjedhjet e fundit për Kuvend të Kosovës si dhe Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune, të mbajtura vitet e kaluara në disa komuna. Planifikimi buxhetit është bërë në nivel të kategorive ekonomike, përkatësisht të zërave duke respektuar legjislacionin financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik dhe në përputhje me strukturën egzistuese të planit kontabël.

Me planin e punës dhe me buxhetin e miratuar të PZAP-it për vitin 2019 nuk kanë qenë të planifikuara këto Zgjedhje, dhe për këtë arsye në bazë të nenit 29 të Ligjit 03/L-048 LMFPP, PZAP-i

si organizatë buxhetore ka kërkuar prej Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrisë së Financave – MF, ndarjen e buxhetit shtesë për mbulimin e shpenzimeve të PZAP-it gjatë këtyre zgjedhjeve.

Kërkesa për buxhet shtesë është planifikuar për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në komunat; Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan në kategorinë e pagave dhe mëditjeve si dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019 në kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Me vendim të Qeverisë të datës 18.04.2019 me Nr.05/98 për PZAP-in është ndarë buxhet shtesë në shumë prej 18,618.18€ për arsye të shpalljes se Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në komunat; Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan. Po ashtu me vendim të Ministrisë së Financave të datës 29.08.2019 me numër të protokollit 1245-1 PZAP-it i janë ndarë buxhet shtesë në shumë prej 43,8570€ për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019 ku prej tyre 18,070.07€ në kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe shuma 25,800€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ky buxhet shtesë është ndarë për angazhimet shtesë gjatë procesit Zgjedhor për anëtarët e PZAP- për stafin e Sekretariatit të PZAP-it, stafin jo permanent të angazhuar gjatë procesit Zgjedhor si dhe për furnizim me formular të ankesave.

Ndryshime në Buxhet ka pasur edhe në fund të vitit për kursime buxhetore ku Qeveria sipas vendimit nr.03/115 të datës 17.12.2019 për PZAP-në janë ndal buxhet prej 9,974.01€ në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ku buxheti final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ka mbetur 163,869.23€.

Në mënyrë të detajuar janë të paraqitura në formë tabelore;

Buxheti fillestar i aprovuar dhe buxheti i ndryshuar gjatë vitit 2019

Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2019	Buxheti i ndryshuar sipas Vendimit të Qeverisë për Kryetar Komune Nr.05/98	Buxheti i ndryshuar sipas Vendimit të Qeverisë Zgjedh. Parakohshme Nr.1245-1	Buxheti i ndryshuar sipas vendimit për kursime Nr. 03/115	Buxheti Përfundimtarë 2019
Paga dhe mëditje	137,155	18,618	18,070	(-9,974)	163,869
Mallra dhe shërbime	73,613		25,800		99,413
Shërbime Komunale	7,820	-	-		7,820
Total:	218,588	18,618	43,870	(-9,974)	271,102


Planifikimi i Buxhetit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat; Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, të mbajtura me 19 maj 2019 dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019

Programet	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe shërbime	Total
PZAP	14,829		14,829
Sekretariati i PZAP-së	21,859	25,800	47,659
Total buxheti:	36,688	25,800	62,488

Struktura e buxhetit për vitin 2019

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it në fund të vitit fiskal në shumë prej 271,102€ si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre :

- 60.45 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,
- 36.67 % të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime, dhe
- 2.88 % për shpenzimet komunale.



Buxheti i Shpenzuar për Vitin 2019

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2019, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it për vitin 2019 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket si në vijim:


Tabela Buxhetit dhe Shpenzimeve - 2019

Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2019	Buxheti i ndryshuar në fund të vitit 2019	Buxheti i shpenzuar- 2019	Përqindja (%) e buxhetit të shpenzuar Për vitin 2017
Paga dhe mëditje	137,155	163,869	163,869	100%
Mallra dhe shërbime	73,613	99,413	79,071	79.54%
Shërbime Komunale	7,820	7,820	376	4.81%
Total:	218,588	271,102	243,316	89.75%


Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve gjatë vitit janë shpenzuar 100% e buxhetit total të pagave, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti është shpenzuar 79.54% të buxhetit të aprovuar për mallra dhe shërbime, në kategorinë e shërbimeve komunale buxheti u shpenzua 4.81% e buxhetit të aprovuar në këtë kategori.

Gjithsejtë buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2019 në shumë prej 243,316€ apo 89.75% e buxhetit të aprovuar të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa.

Paraqitja grafike sipas kategorive ekonomike



Paraqitja grafike e krahasimit të shpenzimeve të vitit 2019 me shpenzimet e vitit 2018



Paga dhe mëditjet

Te kategoria e pagave dhe mëditjeve buxheti fillestar i aprovuar ka qenë 137,154.99€ . Me vendim të Qeveris të datës 18.04.2019 me Nr.05/98 për PZAP-in është ndarë buxhet shtesë në shumë prej 18,618.18€ për arsye të shpalljes se Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat; Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan. Po ashtu në këtë kategori me vendim të Ministrisë së Financave të datës 29.08.2019 me numër të protokollit 1245-1 ka ndarë buxhet shtesë në shumë prej 18,070.07 për arsye të shpalljes së Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës


së Kosovës të mbajtura me 6 tetor-2019. Ky buxhet shtesë është ndarë për angazhimet shtesë gjatë procesit zgjedhor për anëtarët e PZAP- dhe për stafin e Sekretariatit të PZAP-it.

Ndërsa në fund të vitit janë bërë kursime buxhetore ku sipas vendimit nr. 03/115 të datës 17.12.2019 për PZAP-në janë ndal buxhet prej 9,974.01€ ku buxheti final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ka mbetur 163,869.23€.

Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori është 163,869.23€, çka do të thotë se buxheti është shpenzuar 100%. Pagat neto për anëtarët e PZAP-së dhe zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-së janë shpenzuar në shumë prej 163,869€, tatimi në paga është 12,331€ kontributi pensional i punëtorit është 7,803€ dhe kontributi i punëdhënësit është 7,803€.


Paga dhe mëditje në €

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2019
Paga dhe mëditje	163,869
Pagat neto përmes listës së pagave për anëtarët e PZAP-it	55,848
Pagat neto përmes listës së pagave për zyrtarët SPZAP-së	80,083
Tatimi i ndalur në të ardhura personale	12,331
Kontributi pensional i punëtorit	7,803
Kontributi pensional i punëdhënësit	7,803



Shpenzimi i Buxhetit shtesë për paga dhe mëditje gjatë periudhës zgjedhore për dy Zgjedhjet

Kategoritë ekonomike	Maj 2019	Qershor 2019	Korrik 2019	Shtator 2019	Tetor 2019	Nëntor 2019	Dhjetor 2019	Gjithsejt
Paga dhe mëditje	3,920	5,736	1,303	4,973	7,753	6,055	2,474	32,316
Pagat neto përmes listës së pagave për anëtarët e PZAP-it	1,628	2,558	581	1,362	3,977	2,558	1,046	13,812
Pagat neto përmes listës së pagave për zyrtarët e SPZAP-it	2,292	3,178	722	3,611	3,776	3,497	1,428	18,504

**Mallra dhe Shërbime**

Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve buxhetit fillestar i aprovuar ka qenë 73,613€. Edhe të kjo kategori me shpalljen se Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019€ me vendim të Ministrisë së Financave të datës 29.08.2019 me numër të protokollit 1245-1 ka ndarë buxhet shtesë në shumë prej 25,800€. Ky buxhet shtesë është ndarë për angazhimin e 15 zyrtarëve jo permanent gjatë procesit të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 tetor-2019 si dhe për furnizim me formular të ankesave për procesin Zgjedhor.

Buxheti në fund të vitit 2019 në kategorinë mallra dhe shërbime është në shumë prej 99,413€.

Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 79,070.98€.

Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:


- Modulit të aprovimeve dhe
- Modulit të blerjeve-prokurimit.

Me poshtë janë të prezantuara në form tabelare shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2019.

Shpenzimet nga mallrat dhe shërbimet sipas nën kodeve ekonomike

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2019
Mallra dhe Shërbime	79,071
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	3,482
Mëditjet për udhëtim zyrtar jashtë vendit	9,720
Akomodimi për udhëtim zyrtar jashtë vendit	6,729
Shpenzime tjera për udhëtim zyrtar jashtë vendit	738
Shërbimet e Arsimit dhe trajnimit	1,100
Shërbimet tjera telefonike vala 900	6,720
Shërbimet kontraktuese tjera	31,810
Shërbimet postare	28
Furnizim me ushqim dhe pije –jo dreka zyrt.-uji	468
Furnizimi për Zyre	3,261
Taks komunale për regjistrim të automjet. Zyrtar	20
Karburant për vetura	1,408.81
Sigurimi i automjeteve	597.81
Regjistrimi i automjeteve	150
Sigurimi i ndërtesave	1,788
Mirëmbajtja, riparimi i automjeteve	1,223
Qiraja e pajisjeve	672
Shërbimet e varrimit	389
Shpenzimet për informim publik	666
Mobileje (me pak se 1000 euro)	5,595
Shpenzime- Vendimet e Gjykatave	55.49
Drekat zyrtare	2,447


Paraqitja grafike e shpenzimeve ne kategorinë mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike



Pjesa përmbyllëse e Raportit të Shpenzimeve

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe databazës të Sekretariatit të PZAP-it mund të përfundojmë se për vitin 2019 Buxheti u shpenzua **243,316€**. Pjesë përmbyllëse e këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2019.

Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuara të PZAP-it për vitin 2019



Të Hyrat e PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP-i) në bazë të nenit 120 paragrafi 1. pika c. të Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 mund të shqiptoj gjoba ndaj një Subjekti Politik në rast se vlerësohet nga Panelit se, ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së.


Gjatë vitit 2019 janë ndërmarr disa aktivitete ku fillimisht është bërë rishikimi i statusit aktual të subjekteve politike që nuk i kanë shlyer borxhet nga vitet e kaluara ku një pjesë e vogël është në proces të përmbartimit nga zyra e përmbartuesi privat.

Në tabelat e më poshtme janë të paraqitura në mënyrë të detajuar borxhet e SP për të gjitha vitet.

Tabela me të dhënat e gjobave të shqiptuara nga PZAP-i ndaj subjekteve politike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 6 tetor 2019

Nr.	Emri i subjektit politik	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	LDK	74,850	74,850	-
2	LVV	14,100	14,100	-
3	PDK	100,100	100,100	-
4	AAK-PSD	89,600	7,500	82,100
5	Srpska Lista	36,500	36,500	-
6	NISMA-AKR-PD	33,900	33,900	-
7	PREBK	250	250	-
8	IRDK	1,200	1,200	-
9	VAKAT	1,100	1,100	-
10	KDTP	1,100	1,100	-
11	PG	1,100	1,100	-
12	PLE	1,100	1,100	-
13	Koalicioni "Sloboda"	5,100		5,100
Totali		360,000	272,800	87,200

Gjobat e shqiptuara nga PZAP-i ndaj subjekteve politike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 6 tetor 2019




Gjobat e shqiptuara të subjekteve politike për Zgjedhjet e Jashtzakonshme për Kryetar në Komunitat, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan 2019

Nr.	Subjekti politik	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobes	Mbetja e Gjobes se pa paguar
1	G.I Srpska Lista	2,000.00	2,000.00	-
2	G.I Srpska Lista	2,050.00	2,050.00	-
3	G.I Srpska Lista	2,100.00	2,100.00	-
Total		6,150	6,150	-


Gjobat e Subjekteve Politike për Zgjedhjet Lokale 22 tetor - 2017

Nr.	Subjekti politik	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobes	Mbetja e Gjobes se pa paguar
1	Alternativa	15,450	13,950	1,500
2	KTAP	2200	-	2200
Total		17,650	13,950	3,700



Të Hyrat e Realizuara gjatë vitit 2019

Nr.	Nr. I vendimit të PZAP	Subjekti politik	Pershkrimi i te hyrave	Pagesa e gjobës	Data e pageses se borxhit
1	Anr.190/2017	Alternativa	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr, 190/2017 të Zgjedhjeve Lokale -2017	3,600	06.03.2019
2	Anr. 2/2019, 3/2019 dhe 4/2019	G.I Srpska Lista	Pages e gjobes sipas vendimit Anr. 2/2019, 3/2019 dhe 4/2019	6,150	21.05.2019
3	Anr.1096/2017	Alternativa	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr, 1096/2017 të Zgjedhjeve Lokale -2017	1,000	13.09.2019
4	Anr.155/2019	PLE	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr, 155/2019 për Zgjedhjet e Parakashme për Kuvend të Kosoves	1,100	15.10.2019
5	Anr.217/2019	PG	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr, 217/2019 për Zgjedhjet e Parakashme për Kuvend të Kosoves	1,100	18.10.2019
6	Anr. 92, 149, 231/2019	PDK	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr, 94, 149, 231/2019 për Zgjedhjet e Parakashme për Kuvend të Kosoves	9,000	21.10.2019
7	Anr.153/2019	PDK	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr, 153/2019 për Zgjedhjet e Parakashme për Kuvend të Kosoves	2,900	29.10.2019
8	Anr.180,193,092,173, 325,331/2019	PDK	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr, 180,193,092,173,325,331/2019 për Zgjedhjet e Parakashme për Kuvend të Kosoves	14,000	15.11.2019
9	Anr.93/117/126/138/146/170/195/2019	PDK	Pagesa e gjobes në bazë të vendimit Anr, 93/117/126/138/146/170/195/2019 për Zgjedhjet e Parakashme për Kuvend të Kosoves	19,100	03.12.2019
10	Anr.90/129/321/2019	G.I Srpska Lista	Pages e gjobes sipas vendimit Anr. 90/129/321/2019	36,500	10.12.2019
Total:				94,450	



Gjatë vitit 2019 në llogarinë e të hyrave të PZAP-it ka pasur realizim të hyrave në shumë prej 94,450€, ku ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Njësia e Teknologjisë Informative dhe Logjistikës

Gjatë periudhës janar-dhjetor - 2019 njësia e TI dhe Logjistikës ka kryer shumë aktivitete:

Njësia e Teknologjisë Informative ka bërë planifikimin, administrimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve të Microsoft të ofruar nga Ministria e Administratës Publike, si dhe mirëmbajtjen dhe administrimin e Ueb faqes dhe Sistemit për Menaxhimin e Rasteve, serverit të domeni-it (rrjetin e brendshëm).

Në funksion të përmbushjes së detyrave që ndërlidhen me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e çështjeve nga teknologjia informative, janë zhvilluar edhe aktivitete të ndryshme sipas kërkesave të zyrtarëve. Në kuadër të aktiviteteve më kryesore nga kjo njësi, është mirëmbajtja dhe azhurnimi në vazhdimësi i Ueb faqes së PZAP-it dhe rrjeteve sociale, ku gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore janë publikuar të gjitha vendimet gjatë Procesit Zgjedhor, formularë, udhëzime, raporti vjetor i punës për vitin 2018 dhe informacione tjera që kanë qenë të dobishme për Institucionin. Në vazhdimësi bëhet ofrimi i përkrahjes teknike në Sistemin për Menaxhimin e Rasteve dhe Teknologjisë Informative. Aktivitete tjera nga kjo njësi ka pasur edhe nga fusha të tjera si logjistike ku është bërë regjistrimi i inventarit në sistemin E-Pasuria dhe SIMFK, janë përgatitur specifikat për furnizim me 10 laptop për kryetaren dhe anëtarët e PZAP-it, furnizim me inventar për zyre, pajisje të teknologjisë informative, furnizim me pajisje për ngrohje, sigurimin e automjeteve zyrtare tërheqja e parave të imta dhe përcjellja e shpenzimit me para të imta, zotimin e mjeteve financiare si dhe punë tjera sipas kërkesave të menaxhmentit dhe zyrtarëve të PZAP-së. Gjithashtu nga kjo njësi në urb faqen e PZAP-it, janë publikuar konkurse për pozita të lira për marrëveshje për shërbime të veçanta gjatë procesit zgjedhor të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë përgatitur specifikat dhe kryer aktivitete tjera sipas kërkesës së menaxhmentit.

Identifikimi i nevojave të PZAP-it për softuer të licencuar për vitin 2020. Aktivitete tjera nga kjo njësi ka pasur me inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve të PZAP-it përmes programit E-pasuria, ku në këtë lëmi kemi pasur aktivitete të vlerësimit dhe ri-vlerësimit të pajisjeve nga teknologjia informative. Duke u bazuar në **Rregulloren MF – NR. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare, kemi të drejtë që të bëjmë rivlerësimin e pasurisë pasi ato janë funksionale dhe në gjendje të rregullt.**

Njësia e Përkthimeve

Koordinatori për përkthim, ka kryer të gjitha obligimet e dala nga PZAP/SPZAP, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

Nga njësia e përkthimeve gjatë 2019 janë kryer disa aktivitete që i përkasin këtyre njësive. Nga njësia e përkthimeve janë përkthyer të gjitha dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të Panelit dhe zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it si: përkthimi i Raportit Vjetor të Punës-2018; Planit të Punës-2019; përkthimi i të gjitha ankesave nga gjuha Serbe në atë shqipe dhe i vendimeve që janë marrë gjatë Procesit Zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të mbajtura më 6 tetor të vitit 2019; përkthimi i agjendave dhe procesverbaleve të takimeve të PZAP-it dhe të Sekretariatit të PZAP-it, si dhe dokumenteve të tjera sipas kërkesës së zyrtarëve.

Nga njësia e të hyrave është bërë pranimi i të hyrave në sistemin e Free Bilancit sipas kërkesave të Departamentit të Thesarit që ka pasur të hyra në llogarinë e PZAP-it.

Nga pranimi i mallit në depo janë bërë të gjitha pranimet e nevojshme që duhet të kryhen rregullisht në bazë të procesit të realizimit të pagesave. Përpos këtyre aktiviteteve, në vazhdimësi janë kryer edhe aktivitete tjera si: kontrollimi i inventarit në depo ku për ç’do fund vit bëhet regjistrimi i të gjithë inventarit dhe i materialit administrativ që janë në depo dhe inventarit që kemi në posedim, ngarkimi i zyrtarëve me material administrativ, ngarkimi dhe shkarkimi i depos si dhe detyra tjera sipas kërkesave të zyrtarëve.

Njësia e Transportit

Nga njësia e transportit gjatë 2019 janë kryer të gjitha shërbimet dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me transport si: mbajtja e evidencave të qarkullimit të veturave zyrtare dhe evidentimi i ç'do kilometër të kaluar gjatë qarkullimit të automjeteve. Në vazhdimësi janë raportuar në mënyrë specifike për ç'do muaj edhe në formë tabelave për shpenzimet e litarëve të shpenzuara për derivate si dhe kilometrat e kaluara për veturë zyrtare.

Të dhënat për kilometrat e kaluara dhe litrat e shpenzuara për janar-dhjetor 2019 për veturat FORD dhe MITSUBISHI

Vetura	KM e kaluar a janar-mars-2019	Litrat e hargjuara janar-mars-2019	KM e kaluar a prill-qershor-2019	Litrat e hargjuara prill-qershor-2019	KM e kaluara korrik-shtator-2019	Litrat e hargjuara korrik-shtator-2019	KM e kaluar a tetor-dhjetor2019	Litrat e hargjuara tetor-dhjetor2019	KM e kaluar a janar-dhjetor r2019	Litrat e hargjuara janar-dhjetor r2019
Ford	2,336	154	1,957	134	1,839	131	4,288	276.6	10,420	696.6
Mitsubishi	1,216	91	1,349	97	325	43	1,206	130.5	4,096	361.5

Gjatë vitit 2019 për veturën zyrtare FORD janë shpenzuar 967 litra karburante dhe 10,420 kilometra të kaluara .

Ndërsa për veturën zyrtare MITSUBISHI për vitin 2019 janë te shpenzuara 362 litra karburante dhe kilometra te kaluara janë 4,096 km.

Përpos këtyre aktiviteteve nga njësia e transportit janë kryer edhe punë tjera si: përcjellje e vazhdueshme e veturave për ndonjë defekt eventual dhe dërgimi për servisim si dhe është bërë servisimi i rregullt i veturave, pranimin e faturave për derivate dhe për servisim të automjeteve, pastrimin e veturave sipas nevojës, shërbimet me transport sipas kërkesave të Kryetares, anëtarëve të Panelit si dhe zyrtarëve te SPZAP-it, shpërndarja e dokumenteve të ndryshme nëpër Institucione si dhe punë te tjera.

Përfundime

Raporti vjetor i punës së PZAP-it për vitin 2019 reflekton vazhdimin e progresit të qëndrueshëm në drejtim të forcimit dhe fuqizimit të funksionimit të institucionit të PZAP-it. Progres po ashtu u shënuar edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit me akteret e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit. Me tutje PZAP-i ka vazhduar bashkëpunimin me institucione evropiane që merren me organizimin e zgjedhjeve dhe me zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.

PZAP ka mbajtur takime të rregullta mujore me qëllim të vendosjes së çështjeve administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it. Efikasiteti dhe efektiviteti i PZAP-it u vërejt në shqyrtimin dhe vendosjen e 514 ankesave dhe apeleve në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 6 Tetor 2019. Zbatimi me suksese i të gjitha këtyre objektivave dhe aktiviteteve nga ana e PZAP-it është rezultat i angazhimit dhe përkushtimit të kryesueses dhe anëtarëve të PZAP-i, si dhe zyrtareve të përhershëm dhe të përkohshëm të sekretariatit të PZAP-it gjatë vitit 2019. PZAP po ashtu ka punuar mjaft shumë në lidhje me ngritjen e transparencës, ku publiku është njoftuar me kohë për të gjitha ngjarjet dhe vendimet e PZAP-it. Rregullisht, vendimet e PZAP-i janë publikuar me kohe në Ueb Faqen e PZAP-it dhe publiku ka mundur të ketë qasje në çdo kohë për tu informuar lidhur me to. Sistemi i Menaxhimit të Ankesave dhe Apeleve, sistem elektronik i cili është zhvilluar më herët, ka funksionuar shumë mirë dhe ka kontribuar në informimin e drejtpërdrejt të publikut për të gjitha informatat e rasteve por institucioni i PZAP i ka kushtuar rendësi të veçantë mos-cenimin e privatësisë së palëve në procedurë lidhur me procedimin e ankesës prej regjistrimit të ankesës/apelit e deri në vendimin përfundimtarë nga PZAP-i. Përveç publikut të gjerë, edhe mediat elektronike (Radio Televizionet dhe portalet) si dhe ato të shkruara kanë pas qasje në të gjitha informatat e kërkuara nga PZAP-i.

Synim i përhershëm strategjik i PZAP-it është përmirësimi i vazhdueshëm i perceptimit të publikut për PZAP-in si një institucion i hapur dhe transparent, i cili ofron informacione të nevojshme mbi rolin dhe veprimtarinë e tij. Sukses në realizimin e këtij objekti mund të konsiderohet numri i lartë i ankesave të paraqitura në PZAP për këto zgjedhje, gjë që vërteton që publiku i beson institucionit të PZAP-it në zgjidhjen e kontesteve zgjedhore. Arritjet e institucionit të PZAP-i për vitin 2019 do të janë motiv shtesë për angazhim të mëtutjeshëm në tejkalimin e sfidave në proceset e ardhshme zgjedhore si nga kryesuesja dhe anëtarët e PZAP-it ashtu edhe nga stafi i Sekretariatit të PZAP-it.

Ngritja dhe zhvillimi i bashkëpunimit me akterët e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit është i bazuar në ligjet e institucioneve që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi merren me zgjedhje dhe me Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2016, në mes të akterëve të zgjedhjeve, PZAP-it, KQZ-së, Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës i cili është hartuar në përputhje me ligjet e aplikueshme me të cilat janë mandatuar këto institucione.

Gjatë vitit 2019 vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve profesionale në përgatitjen e dokumenteve të rëndësishme të institucionit, përgatitjen e

vendimeve, përgatitjen e rregulloreve, përgatitjen për proceset e ardhshme zgjedhore, pjesëmarrja e anëtarëve të PZAP-it dhe zyrtareve të Sekretariatit në trajnime dhe punëtori dhe vizita jashtë vendit etj..

Aktivitetet e PZAP-it në përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor në Kosovë

Gjatë vitit 2019 me iniciativën e zyrës së Bashkimit Evropian dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë si dhe në bashkëpunim me faktorët tjerë vendor dhe ndërkombëtar në Kosovë, janë ndërmarrë disa veprime me qëllim të përmirësimit dhe forcimit të procesit zgjedhor në Kosovë, por që kjo iniciativë ka mbetur në fazën fillestare të punës së saj për shkak të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019.

Iniciativa ka pas të bëjë me Shqyrtimin e rekomandimeve të misioneve vëzhguese të BE-së, lidhur me proceset zgjedhore në Kosovë gjatë periudhës 2013-2017;

Me Vendimin e Kuvendit të Kosovës nr. 06-V-344 të datës 15.04.2019 është formuar Komisioni Ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor. Komisioni ka pasur për qëllim të shqyrtoj 34 rekomandimet e misioneve vëzhguese të zgjedhjeve dhe të ja dërgoj Grupit këshillëdhënës për trajtim të mëtejshëm Komisioni ka përgatitur Planin e punës në të cilin janë planifikuar aktivitetet gjatë periudhës maj-korrik 2019, në bazë të mandatit sipas vendimit të Kuvendit dhe rregullores së punës së Kuvendit.

Plani ka paraparë edhe krijimin e Grupit këshillëdhënës për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor me përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve relevante që merren me procesin zgjedhor, partneret ndërkombëtarë etj., i cili Grup do të mbështesë komisionin në punën e tij.

Përbërja e komisionit ka qenë nga përfaqësuesit e 11 subjekteve politike të Kosovës.

Komisioni ka pasur për objektiv nxjerrjen e rekomandimeve për të përmirësuar dhe forcuar procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës bazuar në raportet e misioneve vëzhguese të Bashkimit Evropian për zgjedhjet në Kosovë. Përfshirjen e akterëve të interesit në këto diskutime. Konsultime me të gjitha forcat politike në Kuvendin e Kosovës dhe dorëzimi në Kuvendin e Kosovës i propozim ndryshimeve ligjore lidhur me përmirësimin dhe forcimin e proceseve zgjedhore në Kosovë.

Fasilitimi i Komisionit dhe Grupit Këshillëdhënës është bërë nga Komisioni i BE-se dhe OSBE-s i cili ka parapare edhe mbajtjen e punëtorive, por për shkak të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019 të gjitha këto aktivitetet janë pezulluar-ndërprerë.

Qëllimi i Grupit Këshillëdhënës ka qenë rishikimi dhe sugjerimi i ndryshimeve në legjislationin aktual në fuqi për zgjedhje. Synimi i përbashkët i këtij grupi ka qenë sigurimi i një procesi stabil të

qëndrueshëm dhe të thjeshtë që përputhet me standardet e njohura zgjedhore dhe që sigurojnë integritet të procesit zgjedhor.

Nevoja për të ndryshuar procesin është për shkak të dy faktorëve: ndryshimi i prioritetëve duke pasur parasysh përvojën e evoluar zgjedhore në Kosovë – raportet evropiane të misionëve të vëzhgimit të zgjedhjeve në Kosovë dhe ndryshimet janë të nevojshme për të siguruar që ligji është në përputhje me standardet. Çdo rishikimi i procesit do të përpiket të thjeshtëson kuadrin zgjedhor dhe ta bëjë atë me efikas.

Iniciativa për këtë reformë zgjedhore ka qenë zotim i përbashkët i faktorëve relevant vendor dhe ndërkombëtarë në Kosovë e cila iniciativë ka pasur për qëllim përgatitjen e një kornize të rishikuar zgjedhore të kërkesave specifike të zgjedhjeve në Kosovë e cila është në përputhje me rekomandimet e BE/MVZ dhe standardet e njohura ndërkombëtare.

Grupit Këshillëdhënës, ka pasur për objektiv:

Te hartoj dhe rekomandoj ndryshimet në kuadrin zgjedhor,

Te ndihmoj përfaqësuesit e subjekteve politike të Kosovës ti adresojnë rekomandimet e BE/MVZ,

Te sigurohet që projekt ligji i rishikuar është në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare me protokollet e dakorduara të BE dhe OSBE-se për kryerjen e kornizës zgjedhore dhe zbatimin e saj.

Grupi këshillëdhënës ka pasur 27 përfaqësues subjekteve politike, institucioneve që merren me zgjedhje, Shoqërisë civile, BE, OSBE, Përfaqësues të ambasadave të akredituara në Kosovë etj.

Ne këtë Grup PZAP-in e kane përfaqësuar Kryesuesja e PZAP-it Gyltene Sylejmani dhe Mulë Desku, kryesues i sekretariatit të PZAP-it kjo ka qenë edhe propozim i OSBE-së.

Grupit Këshillëdhënës për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor (Grupi Këshillëdhënës) ka mbajtur takimin konstituiv me datën 13.06.2019 dhe takimet tjera të radhës me 21.06.2019, me 24.06.2019 dhe me 28.06.2019.

Në takimin konstituiv kryesuesja e PZAP-it znj. Gyltene Sylajmani është zgjedhur nënkryetare e Grupit Këshillëdhënës për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, ndërsa kryetare është zgjedhur Kryesuesja e Komisionit Qendror Zgjedhor znj. Valdete Daka.

PZAP-i edhe në të ardhmen do të kontribuoj në ofrimin e ekspertizës profesionale në kuptim të përmirësimit dhe forcimit të procesit zgjedhor.

Nr.	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Ndryshimi ligjor	Ndryshimi administrativ
1	Zgjedhjet e parakohshme në mënyrë ideale duhet të thirren me të njëjtin njoftim sikur zgjedhjet e rregullta. Minimumi absolut për zgjedhje që garantojnë të gjitha të drejtat lidhur me zgjedhjet do të jetë njoftimi prej dy muajsh. Para çdo ndryshimi të kornizës ligjore, thirrja për zgjedhje të parakohshme në më pak se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit duhet të shmanget.	Ndryshimi I Kushtetutës (neni 66.2); Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme neni 4, dhe Rregullores së KQZ-së Nr. 15/2013	Kuvendi i Kosovës dhe KQZ	Kushtetuta dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Rregullat e KQZ-se
2	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) duhet të ndryshohet për të inkorporuar rregullat themelore zgjedhore aktualisht të përcaktuara në rregulloret e KQZ-së, p.sh. për funksionimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, rregullat për rinumërim dhe anulime. Kapitulli për ankesat do të përfitonte nga një qartësi më e madhe në lidhje me afatet dhe përmbajtjen e nevojshme të ankesave.	Ndryshimi dhe konsolidimi i LZP-së së ndryshuar. Një ndryshim që prek pjesë të konsiderueshme të tekstit po ashtu do të çojë në botimin shumë të nevojshëm të një versioni të konsoliduar të LZP dhe Ligjit (s) Amendamentit.	Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me KQZ-në, PZAP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Jo

3	Sigurimi i sigurisë ligjore dhe kushtetuese për kërkesat e kandidatëve për t'u kualifikuar pas vendimit të Gjykatës Supreme për dekertifikimin e kandidatëve.	Ndryshime ne Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme	Kuvendi i Kosovës me KQZ-në, PZAP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Jo
4	LZP duhet të ndryshohet për të siguruar qartësi lidhur me afatet dhe përmbajtjen e nevojshme të ankesave dhe apelimeve. Afatet për paraqitjen e ankesave në zgjedhje duhet të zgjasin deri në 48 orë dhe afatet kohore për PZAP për të vendosur mbi ankesat kundër rezultateve të zgjatura deri në 5 ditë.	Të ndryshojë dhe konsolidojë LZP-në e ndryshuar	Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me KQZ-në, PZAP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	No
5	T'i ofrohen PZAP-së resurset adekuate, duke përfshirë hapësirën për të punuar në një numër të madh të rasteve në një kohë shumë të shkurtër.	Të rriten resurset e PZAP-së, të ofrohen hapësirat adekuate.	Ministria e Financave, MAPL, në bashkëpunim të ngushtë me KQZ-në, PZAP	Jo	Po (burime)
6	PZAP dhe Gjykata Supreme duhet të publikojnë ankesat dhe apelet dhe vendimet në faqet e tyre në kohë.	Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat.	Kuvendi i Kosovës, PZAP dhe Gjykata Supreme	PO ligji mbi Gjykatat	Po (praktikat)
7	Degët e PZAP duhet të jenë të hapura në shtatë rajone gjatë zgjedhjeve.	Ndryshime ne Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme	Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me PZAP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme	Po (praktikat)
8	Procedurat e ankesave duhet të përfshihen në manualin e trajnimit të KVV dhe në informatat e përgjithshme për votuesit.	Ndryshimi i manualit të trajnimit të KVV-së, të krijojë një edukim adekuat të votuesve.	KQZ, PZAP	Jo	Po (trajnimi)

9	Të gjitha krimet zgjedhore, përfshirë edhe ato të kryera gjatë zgjedhjeve të mëparshme, duhet të hetohen në mënyrë energjike, të ndiqen penalisht, dhe aty ku përcaktohet përgjegjësia personale, të ndëshkohen. Zinxhirët e komandës duhet të hetohen dhe të ndiqen penalisht nxitësit. Institucionet duhet të sigurojnë hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e shpejtë dhe të duhur të rasteve të mashtrimit zgjedhor.	Kryerja e hetimeve të plota, ndjekjen penale dhe gjykimin në lidhje me akuzat për krime elektorale. Siguron botimin e rregullt dhe të gjerë të rezultateve të këtyre përpjekjeve.	Policia, Prokuroria, Gjykatat, Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Jo	Po (praktikat)
10	Prokurorët e posaçëm për zgjedhje duhet t'i caktohen secilës komunë tashmë me fillimin e periudhës së fushatës. Institucionet duhet të sigurojnë hetim të shpejtë dhe të duhur, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të kërcënimeve ndaj votuesve dhe kandidatëve.	Kryerja e hetimeve të plota mbi pretendimet e frikësimit/ presionit p.sh. duke caktuar prokurorë special për secilën komunë që në fillim të periudhës së fushatës.	Policia, Prokuroria, Gjykatat, Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Jo	Po (burime)
11	Duhet të krijohet një bazë të dhënash me një numër të vetëm, ku rastet lidhur me zgjedhjet mund të gjurmohen nga policia në prokurori deri te vendimi i gjykatës. Nëse kjo bazë e planifikuar e të dhënave nuk bëhet funksionale deri në janar 2018, duhet të zbatohet një sistem i veçantë.	Krijimi i një bazë të dhënash me një numër të vetëm, ku rastet mund të përcillen nga policia në prokurori deri te vendimi i gjykatës.	Policia, Prokuroria, Gjykatat, Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Jo	Po (burime / baza e te dhënave)

12	Partitë politike duhet të identifikojnë masa efektive për të rritur pjesëmarrjen e grave në pozita udhëheqëse në aktivitetet partiake / fushatë zgjedhore.	Ndryshimet e rregullave të brendshme të procedurave të partive politike	Subjektet politike dhe Shoqëria Civile	Jo	Po (rregulloret e partisë / statuti)
13	Të sqarohen dispozitat e LZP-së lidhur me përfshirjen e të miturve në fushatën elektorale	Ndryshime në Rregulloren e Zgjedhjeve të KQZ-së nr. 13/2013	KQZ, Partite / Kandidatet	Jo	Po (rregulloret dhe praktikat)
14	Të bëhet një rishikim gjithëpërfshirës i kornizës ligjore që rregullon fushatën dhe financimin e partive politike	Ndryshime në Ligjin nr. 03 / L-174 për financimin e partive politike	Kuvendi I Kosovës dhe KQZ	po	Jo
15	Auditimi i financave të fushatës së garuesve të zgjedhjeve duhet të kryhet në mënyrë efektive	Kuvendi i Kosovës duhet të identifikojë një institucion të pavarur që ka për detyrë kryerjen e auditimeve të raporteve financiare.	Kuvendi I Kosovës dhe KQZ	Unclear	Yes (decision)
16	Auditimi i financave të fushatës së garuesve të zgjedhjeve duhet të kryhet në mënyrë efektive.	Kuvendi i Kosovës duhet të vazhdojë auditimin e financave të partive politike në përputhje me ligjin aktual dhe duhet të ndajë çdo vit fonde të mjaftueshme për auditim. Rritja e burimeve të Zyrës së KQZ-së për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike për të siguruar trajnimin e duhur të zyrtarëve financiarë të partive politike.	Kuvendi I Kosovës dhe KQZ	Jo	Po (burimet/fonde, trajnim)

17	Subjekteve politike duhet të kërkohet të mbajnë llogari të veçanta bankare për financimin e fushatës, duke bashkuar të gjitha burimet e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë fushatës, në nivel qendror dhe rajonal	Ndryshime në Ligjin nr. 03 / L-174 për financimin e partive politike dhe konsultimet publike me aktorët relevantë për të identifikuar institucionin adekuat për të kryer një auditim të pavarur të raporteve financiare	Kuvendi I Kosoves dhe KQZ	Po	Jo
18	Pjesëmarrësit në zgjedhje duhet të paraqesin raporte financiare jo më vonë se 30 ditë pas ditës së zgjedhjeve.	Ndryshime në LZP.	Kuvendi I Kosoves dhe KQZ	Po - LZP	Jo
19	Kapaciteti i organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar financimin e fushatës dhe mediat duhet të forcohet duke siguruar më shumë burime dhe trajnime.	Resurset dhe metodologjia duhet të vihen në dispozicion të organizatave të shoqërisë civile	Organizatave të shoqërisë civile	Jo	Po (burimet, trajnim)
20	Rregullat e fushatës lidhur me njoftimin dhe organizimin e ngjarjeve politike, rregullat për postime zgjedhore dhe rregullat për përfshirjen e nëpunësve civilë në fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen më tej në LZP.	Ndryshimi i LZP për të përfshirë dispozitat që aktualisht gjenden në rregulloren zgjedhore nr. 13/2013 për fushatat zgjedhore.	Kuvendi I Kosoves dhe KQZ	Po (LZP)	Jo

21	Përmirësimi i dizajnit të fletëvotimeve për zgjedhjet për kuvendet komunale që votuesit t'i kuptojnë më mirë. Të përmirësohet informimi i votuesve për mënyrën se si duhet të shënjojnë një fletëvotim.	Analizimi i fletëvotimeve të pavlefshme nga zgjedhjet lokale të vitit 2017 dhe aplikimi i dizajnit të ri të fletëvotimeve për zgjedhjet për kuvendet komunale. Informimi i votuesve duhet të përdorë kanale të ndryshme për të qenë më efektiv.	KQZ	Jo	Yes (practices)
22	Te intensifikohen trajnimet e stafit e vendvotimeve për të adresuar mangësitë e përsëritura siç janë moszbatimi i procedurave të numërimit të votave dhe plotësimi jo i saktë i formularëve të rezultateve. Të krijohet pozita e Sekretarit të KVV-së për të siguruar mbështetjen e nevojshme këshilluese dhe administrative për Kryesuesin e KVV-së. Sekretari mund të rekrutohet dhe trajnohet nga KQZ/KKZ nga radhët e anëtarëve të administratës publike.	KQZ-ja dhe KKZ-të do të vlerësojnë sistematikisht performancën e anëtarëve të KVV-ve dhe do të vendosin dhe mirëmbajnë bazën e të dhënave të stafit të vendvotimeve. Përmirësimi i materialeve të trajnimit dhe kurrikulës për stafin e vendvotimeve dhe Kryesuesin e KVV-ve.	KQZ	No	Yes (training/resources)
23	Aplikimi i masave shtesë për verifikimin e votuesve të VjK-së për të mbrojtur integritetin e Votimit jashtë Kosovës kundër mashtrimit dhe paraqitjes së rreme si person tjetër. Shqyrtimi i afateve kohore për paraqitjen e listës së votuesve dhe periudhën e kundërshtimit që të mundësohen mjete juridike efektive për	Ndryshime në rregulloren e KQZ-së 03/2013 dhe 10/2013	KQZ	Jo(LZP)	Po (rregullat)

	rastet e refuzimit të mundësisë për të votuar.				
24	Dedikimi i përpjekjeve substanciale për të hequr personat e vdekur nga regjistrat civilë, dhe për të krijuar një sistem të unifikuar të adresave në Kosovë.	Ndryshime se si raportohen dhe regjistrohen rastet e vdekjes. Agjencia e Regjistrimit Civil dhe institucionet përkatëse të zbatojnë një sistem të unifikuar të adresave, dhe KQZ të caktojë si duhet votuesit nëpër vendvotime.	RQC / KQZ / Ministria e punëve të brendshme/ Zyra Kadastrale e Kosoves/Komunat	Jo	Po (praktikat / sistemet / burimet)
25	Në rastin e zgjedhjeve të parakohshme duhet të zgjatet afati kohor për, ndër të tjera, për shfaqjen e listës së votuesve dhe periudhën e sfidave, për aplikimet për votim të veçantë, për regjistrimin dhe votimin jashtë Kosovës dhe për emërimin e vendvotimeve.	Ndryshime në Kushtetutën, LBGJ, Rregulloren e KQZ-së nr. 15/2013.	Kuvendi i Kosoves dhe KQZ	Po (Kushtetuta dhe LZP)	Po (rregullat)
26	Zbatimi i deklaratës së partive politike për vitin 2015 për të siguruar së paku 40 përqind pjesëmarrjen e secilës gjini në procesin zgjedhor.	Ndryshime të Rregullores së KQZ-së 18/2016 dhe 19/2016	Partitë / KQZ	Jo	Po (rregullat dhe praktikat)

27	Procesi i tabelimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve duhet të përmirësohet në mënyrë substanciale duke siguruar më shumë resurse, trajnim të stafit dhe përmirësim të teknologjive. FRK-të dhe FPR-të duhet të qartësohen.	Të ri-dizajnohen operacionet e KQZ-së për të përdorur teknologjitë moderne për përmirësimin e saktësisë dhe informimit dhe qasjen e vëzhguesit në të gjitha fazat e tabelimit, numërimit dhe rinumërimit	KQZ, QNR, IFES, Donatorët Ndërkombëtarë	Jo	Po (rregullat dhe praktikrat, trajnimi dhe teknologjia)
28	Procedurat për trajtimin e votave me kusht duhet të qartësohet, veçanërisht sa i përket verifikimit të identitetit dhe të drejtës; vëzhguesit duhet të jenë në gjendje të vëzhgojnë procesin e verifikimit.	Qartësimi i procedurave të votimit me kusht, ofrimi i mundësive për vëzhgimin e trajtimit të votave me kusht	QNR, KQZ	Jo	Po (rregullat dhe trajnimi)
29	Përfshirja e trajnimit të kryetarëve të KVV-ve me një fokus të veçantë në parandalimin e votimit familjar / grupor dhe keqpërdorimit të votimit të ndihmuar. Përfshirja e modulit ligjor mbi procedurat e ankesave dhe përgjegjësisë penale në seancat trajnuese të KVV-ve të kryera nga trajnuesit në vend që t'i referohen prokurorëve.	Përmirësimi i moduleve të trajnimit dhe përmirësimi i Manualëve të Votimit për Anëtarët e KVV-ve	KQZ/PZAP	Jo	Po (trajnimi dhe doracaket)

30	Zbatimi i edukimit gjithëpërfshirës dhe në kohë i votuesve dhe informimi i votuesve për të drejtën për të votuar në zgjedhjet lokale (si të plotësohet një fletëvotim, si të gjeten vendvotimet dhe si të gjej komunën ku një votues ka të drejtë të votojë, si të aplikoj për votim përmes VjK ose për ndihmë në votim, Informacioni i votuesve duhet të rritet ndjeshëm; në veçanti, sa i përket plotësimit të fletëvotimit, si të regjistrohen dhe të votojnë jashtë Kosovës, si të ndryshohet vendvotimi, ID të pranueshme. cilat dokumente pranohen për identifikimin e votuesve, krimet zgjedhore, procedurat e ankesave).	Të bëhen fushata për informimin e votuesve dhe fushata për edukimin e votuesve duke përdorur kanale të ndryshme (media online, media sociale, bashkëpunim me OJQ-të) dhe targetimi i grupeve të ndryshme të votuesve.	KQZ	Jo	Po (rregullat)
31	Duhet marrë në konsideratë rregullimin e programeve të sponsorizuara nga partitë politike ngjashëm me spotet reklamuese politike me pagesë.	Ndryshimi i Rregullores KPM-2016/02 të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) Komisionit të Pavarur për Media. Ndryshimi Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme	Kuvendi i Kosovës, Komisioni i Pavarur për Media	Po (LZP)	Po (rregullat e KPM)

32	Duhet marrë në konsideratë emërimin me kohë të të shtatë anëtarëve të KPM-së dhe tre anëtarëve të Bordit të ANkesave për të garantuar kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimeve.	Sigurimi i vazhdimet me kohë të mandateve të anëtarëve të KPM-së dhe angazhimi i tyre I plotë për të garantuar lehtësisht kuorumin e nevojshëm për të mbajtur takimet dhe për të marr vendime. Zbatimi i Nenit 11 dhe Nenit 38, Ligji për Komisionin e Pavarur për Media.	Kuvendi i Kosovës, Komisioni i Pavarur për Media	Jo	Po (emërimi, zbatimi, mundësia e Koordinimit, rregulloret).
33	Duhet marrë parasysh që KPM-ja të mbajë takime të rregullta dhe të shpeshta gjatë periudhës së zgjedhjeve. për të adresuar ankesat e pranuar dhe shkeljet e zbuluara nga departamenti i monitorimit të medias.	Të mbahen mbledhje të rregullta dhe të shpeshta të anëtarëve të KPM-së gjatë periudhës së zgjedhjeve për të adresuar ankesat e pranuar dhe shkeljet e zbuluara nga departamenti i monitorimit të medias. Zbatimi i Nenit 15.3 i Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.	Komisioni i Pavarur për Media	Jo	Po (praktikat)
34	Duhet marrë në konsideratë që të ndahen me publikun në mënyrë aktive informacionet mbi aktivitetet dhe gjetjet e KPM-së.	Të lëshohet deklarata publike nëpërmjet medias elektronike dhe të organizohen konferenca shtypi për të paraqitur raporte mbi gjetjet e saj, veçanërisht rezultatet dhe vendimet e monitorimit të mediave lidhur me zgjedhjet. Zbatimi i nenit 5.2 i Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.	Komisioni i Pavarur për Media	Jo	Po (qasje / praktika)

Sfidat

Mungesa e hapësirave fizike për anëtarët e PZAP-it dhe zyrtarët e Sekretariatit, të nevojshme për kryerjen e punëve dhe zhvillimin veprimtarisë së tyre është një sfidë që po na përcjellë ndër vite dhe duket që kjo sfidë do vazhdojë edhe në të ardhmen. PZAP-i ka kërkuar ndihmën dhe përkrahjen e Ministrisë së Administratës Publike për zgjidhjen e kësaj çështje, por që deri me tani nuk është zgjidhur. Mungesa e hapësirave do të vazhdojë të vështirësoj zhvillimin e veprimtarisë së institucionit të PZAP-it në aspektin teknik dhe organizativ të stafit edhe në të ardhmen.

Shpërndarja e Formularëve të ankesave ka qenë një sfidë tjetër e PZAP-it. Për shkak të ekonomizimit të kohës, në të gjitha proceset e kaluara zgjedhore deri në vitin 2016, shpërndarjen e Formularëve të ankesave e ka bërë sekretariati i KQZ-së bashkë me materialin zgjedhor të KQZ-se, ndërsa në dy palë të zgjedhjeve të vitit 2017 dhe në zgjedhjet e vitit 2019, shpërndarjen e Formularëve të ankesave e kanë bërë vetë zyrtarët e PZAP-it. Mos shpërndarja e Formularëve të ankesave nga ana e sekretariatit të KQZ-se e ka sfiduar PZAP-in për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore të sekretariatit të PZAP-it.

Dërgimi i ankesave dhe apeleve përmes postës, në adresë të PZAP-it, nga palët e interesuar, ka qenë një sfidë tjetër për PZAP-in, për shkak se gjatë zgjedhjeve të kaluara, një ankesë nga data e dorëzimit në Postë e deri ne pranimin e saj në PZAP është vonuar deri në 11 ditë. Vonesat e tilla të shërbimeve postare e vështirësojnë procesin zgjedhorë në tersi konkretisht certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Për fund, Kryesuesja e PZAP-it në emër të institucionit shpreh falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për të gjitha anëtarët dhe stafin e sekretariatit të PZAP-it për kontributin e tyre të dhënë në përmbushjen e mandatit të PZAP-it si dhe falënderon dhe shprehe mirënjohje për institucionet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë, në veçanti për: Qeverinë e Republikës së Kosovës për ofrimin e përkrahjes financiare në përmbushjen e aktiviteteve gjatë zgjedhjeve, Misionin e OSBE-së në Kosovë për përkrahje financiare dhe profesionale në ngritjen e kapaciteteve, dhe për Fondacionin Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore – IFES për përkrahjen profesionale në ngritjen e kapaciteteve të PZAP-it.